



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 235/1 prot.

Tiranë, më 05 . 02 . 2024

V E N D I M

Nr. 33 , Datë 05 . 02 . 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 138, datë 03.07.2023, të E.L kundër Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier (DRAP Fier), në të cilën pretendohet për diskriminim “për çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Kam filluar punë si drejtuese e shkollës speciale Vlorë, me datë 17.10.2022. Menjëherë me marrjen e detyrës konstatova shkelje të natyrës të shpërdorimit e detyrës, si regjistrimin fiktiv që konstatonin në dy aspekte. Duke mos qenë me diagnozë bënin pjesë dhe fëmijë të shëndetshëm si dhe fëmijë inekzistentë, pasi ndodheshin ndërkohë jashtë vendit apo shkolla të tjera. Mjafton, kjo arsye që të njoftoja ZVAP Vlorë dhe DRAP Fier. Duke konstatuar dhe humbjen e regjistrave të cilët lidhen me regjistrimin e fëmijëve, ku vërtetohet dhe fiktiviteti i tyre, si dhe shumë shkelje të karakterit penal dhe duke mos pasur një përgjigje apo audit nga ana e institucioneve nga varen, bëra kallëzim penal pranë Prokurorisë së rrethit Vlorë, më datë 02.03.2023. Në këtë kallëzim penal përpara oficerit të krimit ekonomik, shpjegova të gjitha konstatimet e mësipërme së bashku me emrat e drejtuesve të institucionit para meje, që në fakt bëjnë pjesë po në stafin e institucionit. Gjithashtu, për këtë kallëzim penal vura në dijeni ZVAP Vlorë, DRAP Fier dhe veçanërisht Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në takimin personal me të. Pas kallëzimit penal, personat e prekur nisën të shkruanin e-mail, mesazhe ndaj meje si drejtuese, duke kërkuar shkarkimin tim,

¹ Për shkak të denoncimeve të bëra nga ana e saj, pasi mori detyrën si drejtuese e shkollës “Speciale PLM” Vlorë.

duke përdorur të gjitha format e shpifjes dhe deformimet e ngjarjeve. Këtyre iu bashkuan edhe Grupi i Monitorimit nga MAS, i cili pasi erdhi në institucion dhe kreu një kontroll, ku evidentoi të gjitha shkeljet e bëra nga drejtuesit dhe çuditërisht në raportin përfundimtar të gjitha shkeljet mi adresojnë mua. Duke mos më dhënë mundësi të parashtroja pretendimet e mia. Me Vendimin nr. 40, datë 16.06.2023, DRAP Fier ka vendosur zgjidhjen e kontratës së punës”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin² në pozicionin e mëparshëm ose në një pozicion të barazvlefshëm me të dhe rifutjen në sistemin arsimor parauniversitar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 765/2, datë 06.07.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjektet, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Kopje të plotë të njoftimeve/informacioneve/denoncimeve të dërguara nga E.L drejtuar, ZVAP Vlorë, DRAP Fier, MAS dhe Prokurorisë Vlorë dhe përgjigjeve të këtyre institucioneve.
 - Kopje të plotë të procedurës së monitorimit të shkollës “Speciale” Vlorë, nga ana e MAS, kopje të raportit të grupit të punës dhe kundërshtimeve të E.L.
 - Informacion nëse është kryer monitorim nga ana e MAS dhe për ndonjë shkollë tjetër, gjatë periudhës 01.06.2022 deri më 30.05.2023, dhe që është rekomanduar masë disiplinore për drejtuesin e shkollës, për të njëjtat shkelje si ankuesja. Nëse po, kopje të procedurës.

² Shtuar nga ankuesja me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 765/7, datë 10.10.2023.

- Kopje të plotë të procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës nga ana e DRAP Fier me E.L. Kopje të kundërshtimit të ankueses (procesverbalin datë 29.05.2023) dhe përgjigjes së dhënë (nëse ka).
- Informacion nëse është marrë masë disiplinore për drejtues të tjerë, për të njëjtat shkelje si ankuesja. Nëse po, kopje të procedurës.
- Kopje të Kontratës Kolektive të Punës, të Rregullores së Brendshme të shkollës speciale, Vlorë, të Rregullores së Brendshme të DPAP Fier dhe kopje të rregullores së funksionimit të Komisionit të Disiplinës të DPAP Fier.

Me shkresën nr. 735/1, datë 14.07.2023, DRAP Fier, dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“DRAP Fier është vënë në dijeni për disa parregullsi në regjistrimin e nxënësve (pretendime të drejtueses së shkollës) nëpërmjet e-mail-it të datës 07.04.2023 të ZVAP Vlorë-Himarë. Këtij e-mail-i i bashkëngjitej edhe shkresa e drejtorisë së shkollës speciale Vlorë e datës 04.04.2023, drejtuar ZVAP Vlorë-Himarë, në të cilën drejtorja e shkollës, E.L shprehet: “Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion mbi përmbushjen e detyrave të lëna pas inspektimeve nga ana e grupit të punës së ZVAP Vlorë-Himarë ju informoj si më poshtë vijon”. Në informacionin që drejtorja e shkollës i dërgon ZVAP Vlorë-Himarë nuk trajtohet çështja e regjistrave të humbur, për të cilën drejtuesja e shkollës kishte bërë kallëzim në prokurori. ZVAP Vlorë ka kryer monitorim dhe ka dalë me konkluzione, pasi është vënë në dijeni për problematikat.*

Gjatë procedurës së zhvilluar nga DRAP Fier është respektuar plotësisht e drejta e ankueses për të shprehur pretendimet e saj.

DRAP Fier kryen funksionet mbështetur në VKM nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar”. Pas vënies në dijeni për problematikat e konstatuara dhe në zbatim të rekomandimeve të raportit të MAS, të përmendur më sipër, DRAP Fier ka hartuar dhe dërguar pranë shkollës speciale Vlorë planin e masave me shkresën nr. 444/4/1, datë 24.05.2023, ku në pikën 4 përcakton detyrën e drejtorisë së institucionit arsimor: “Ngritjen e grupit të punës dhe vijimi i bashkëpunimit me organet ligjzbatuese nëse hasen problematika, për të cilat lind dyshimi i arsyeshëm për falsifikim të dokumentit shkollor”. DRAP Fier ka kryer monitorim në shkollën speciale Vlorë për zbatimin e masave lidhur me rekomandimet e lëna nga grupi i punës i MAS. Në përfundim të monitorimit është hartuar raporti nr. 580/2, datë 01.06.2023, me të cilin është vënë në dijeni zyrtarisht edhe MAS.

DRAP Fier kryen monitorime dhe inspektime në institucionet arsimore sipas planifikimit, apo në zbatim të urdhrave nga DPAP për problematika të caktuara dhe ankesa.

E.L pretendon se ka njoftuar në datën 08.02.2023 ZVAP Vlorë-Himarë për shkeljet e përmendura në ankesë. Por, më herët, në datën 21.12.2022 një grup mësuesish të kësaj shkolle i është adresuar me ankesë ZVAP Vlorë-Himarë duke vënë në dijeni DRAP Fier, mbi

problematika të komunikimit të drejtores, E.L, me punonjësit në vartësi, si edhe për keqmenaxhim të institucionit arsimor, mosrealizim të detyrave nga kjo drejtuese (mungesë komunikimi, frymë mosbashkëpunimi, klimë konfliktuale dhe zhvlerësim të figurës së mësuesit në shkollë). Raporti i vlerësimit i ZVAP Vlorë, dërguar në DRAP Fier me shkresën nr. 3002/2, datë 29.12.2022, përfshin edhe anketim me personelin e institucionit arsimor, ku sjellja e drejtueses ndaj mësuesve konsiderohet në nivele të larta negative. Në datën 06.02.2023 DRAP Fier ka dhënë konkluzione pas verifikimit të ankesave të mësuesve të shkollës speciale Vlorë. Menjëherë pas këtyre veprimeve të ZVAP dhe DRAP, të kryera në funksion të përmbushjes së detyrave funksionale, E.L pretendon se ka njoftuar ZVAP me datë 08.02.2023 për humbjen e disa regjistrave, për të cilën ngre dyshime mbi punonjës të shkollës, të cilët më parë kishin drejtuar ankesa ndaj saj. E.L, në procesverbalin e takimit të mbajtur në DRAP Fier nr. 615, datë 12.06.2023, ka pohuar se mungojnë regjistrat, që pranon që i ka marrë me inventar. Si drejtuese e institucionit arsimor ajo ka pasur detyrimin të zbatojë rregulloren “Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me Urdhrin e MAS nr. 31, datë 28.01.2020, si edhe legjislacionin mbi arkivat (ligjin dhe rregulloren për normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë) ku përfshihet edhe mënyra e administrimit të dokumentacionit shkollor.

Për sa i përket informacionit mbi masa disiplinore për drejtues të tjerë, për të njëjtat shkelje si ankuesja, ju informojmë se nuk ka pasur raste të ngjashme, kur shkelje të rënda të drejtuesve të institucioneve arsimore, të konstatuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, të jenë referuar në DRAP Fier për masë disiplinore”.

Me shkresën nr. 4344/1, datë 18.07.2023, Ministria e Arsimit dhe Sportit dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Ministria e Arsimit dhe Sportit me Urdhrin nr. 186, datë 14.04.2023, ka ngritur grupin e punës për monitorimin e veprimtarisë së shkollës speciale Vlorë. Monitorimi është kryer sipas platformës së monitorimit nr. 2511/1, datë 14.04.2023. Monitorimi është kryer në periudhën 14.04.2023-21.04.2023.

Në përfundim të monitorimit, grupi i punës ka hartuar “Raportin mbi monitorimin e shkollës speciale Vlorë”, me nr. 2511/2, datë 08.05.2023. Me shkresën e MAS nr. 2511/3, datë 09.05.2023, me lëndë “Dërgohet raporti i grupit të punës mbi monitorimin e shkollës speciale Vlorë”, raporti i grupit të monitorimit i është përcjellë shkollës speciale Vlorë, ZVAP Vlorë, DRAP Fier si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP).

E.L, në cilësinë e drejtorit të shkollës speciale Vlorë, nuk rezulton të ketë depozituar pranë MAS, objeksione për kundërshtimin e përmbajtjes së raportit të monitorimit si dhe propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj saj.

MAS gjatë periudhës 01.06.2022-30.05.2023, nuk ka monitoruar institucione të tjera të arsimit parauniversitar”.

Në përgjigje të parashtrimeve të DRAP Fier dhe MAS, ankuesja me shkresën datë 23.07.2023, të protokolluar me tonën nr. 765/5, datë 25.07.2023, parashtoi se: “*DRAP Fier shprehet për pikën e parë se parregullsitë në regjistrimin e nxënësve janë pretendime të drejtueses së shkollës.*”

Janë dy opsione: ose DRAP Fier NUK ka ushtruar funksionin e saj për të monitoruar institucionet arsimore nën juridiksionin e saj, konkretisht shkollën speciale, ose me dashje NUK DO dhe arsytet i dinë ata pse, pasi në zbatueshmëri të ligjit do duhet të kishin vepruar ndaj të gjithë personave që kanë bërë shkelje. Të gjitha dokumentacionet e nevojshme që përcaktojnë ligjshmërinë dhe paligjshmërinë e regjistrimit të fëmijëve prej vitesh janë në institucion. Në shkollë rezultoni fëmijë të regjistruar në kundërshtim me ligjin qysh prej vitit 2014. Madje regjistrimi i këtyre fëmijëve ka bërë të mundur të hapen klasat, gjithashtu punësuar mësuese duke shkaktuar edhe një dëm financiar në buxhetin e shtetit.

Pretendimi i DRAP Fier ku informon se drejtoria e shkollës speciale në shkresën e datës 04.04.2023 drejtuar ZVAP-së nuk trajton çështjen e regjistrave të humbur është e pavërtetë. Në cilësinë e drejtoreshës së shkollës speciale, në aktin shkresor me nr. 108, datë 04.04.2023, ZVAP-së i kam përcjellë informacion përsa i përket gjithë shkeljeve të natyrës penale të kryera nga ish drejtueset A.I dhe E.K.

a) Informacion për paligjshmëri në regjistrimin e nxënësve reflektuar qysh nga koha kur shkolla drejtohej nga A.I dhe më pas nga E.K. Në tabelën pasqyruese shihet qartë që klasat janë hapur në kundërshtim me ligjin 69/2012 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në IA”.

b) Informacion në lidhje me nxënës të regjistruar fiktivë. Konkretisht nxënësi H.D me nr. Amze 546, që sipas informacionit të siguruar nga anëtarë të stafit, mbështetur edhe nga deklarimi i ish drejtueses së ZVAP-së A.B në mbledhjen e stafit referuar procesverbalit nr. 10, datë 02.11.2020 ishte nxënës i shkollës “Musa Çakërri”. Gjithashtu edhe nxënësja V.M me nr. amze 562, po sipas informacioneve nga stafi mësimor, edhe pse ishte regjistruar dhe vlerësuar për 4 vite mësimorë, rezultonte të ishte jashtë vendit (Greqi). Ndërkohë për të dy rastet i kam kërkuar ZVAP-së, si institucioni epror, të bëjë verifikimet. Deri në datë 16.06.2023 kjo gjë nuk ndodhi nga asnjë prej institucioneve eprorë ZVAP Vlorë, DRAP Fier, DPAP dhe MAS. Në cilësinë e drejtorit të shkollës speciale, i jam drejtuar me anë të një kërkesë për informacion me nr. 151, datë 31.05.2023 drejtorisë së shkollës “Musa Çakërri” për të cilën kam vënë në dijeni edhe ZVAP-në. Përgjigje që nuk erdhi deri në datën 16.06.2023.

c) Gjithashtu në aktin shkresor nr. 108, datë 04.04.2023 informoj drejtuesen e ZVAP-së I.T për depozitim në organet ligjzbatuese të një kallëzimi penal për çdo problematikë të konstatuar, duke iu referuar edhe rekomandimit të saj dhënë përmes aktit shkresor me nr. 324/3, datë 23.02.2023 ku midis të tjerave citon: “Përsa më sipër, në cilësinë e titullarit të institucionit arsimor, lutemi të vijoni menjëherë me kryerjen e veprimeve të nevojshme për raportimin e

humbjes së dokumentacionit shkollor në organet ligjzbatuese”. Pra institucionet eprorë kanë qenë në dijeni të çdo problematike të konstatuar në institucion nga ana ime.

Lidhur me argumentin e DRAP Fier, lidhur me pretendimin tim nr. 2 “Reagimit nga personat që prekeshin prej kallëzimit penal të kryer nga E.L iu bashkua edhe grupi i monitorimit i MAS, i cili ia ka adresuar ankueses shkeljet e konstatuara në shkollë” deklaroj se argumentimi i DRAP Fier është inekzistues nga pikëpamja e logjikësformale, si dhe e logjikës procedurale dhe juridike, sepse sigurisht që pretendimi i parashtruar nga ana ime si drejtuese e shkollës speciale përfshin dhe nënkupton drejtpërsëdrejti DRAP Fier të cilët nuk kanë bërë asgjë zyrtarisht dhe konkretisht lidhur me informimet që u kam bërë në rrugë zyrtare, lidhur me situatën krejt anormale në të cilën ndodhej shkolla speciale nga momenti që jam emëruar si drejtuese.

Detyra ime pas besimit që mu dha si drejtuese e shkollës ishte: - të konstatoja situatën; - të informoja organin epror ZVAP Vlorë.

Pra, si konkluzion jo shterues eprorët e mi nuk dëshironin rregullimin e situatës dhe eliminimin e mangësive në shkollën speciale Vlorë, por ruajtjen e gjendjes ekzistuese duke ruajtur situatën destruktive në pikëpamje organizative dhe juridike në të cilën gjendej shkolla speciale për shkak se mbante të punësuar elementë që në vend të ishin në shërbim të detyrës për të cilën paguheshin, dëshironin të kryenin korrupsion lidhur me:

- *regjistrimet absolutisht të pavlefshme nga pikëpamja juridike dhe procedurale, sepse mbanin në shkollë elementë pa diagnozë,*
- *nëpërmjet regjistrimeve antiligjore janë krijuar klasat, jashtë logjikës së organizimit dhe frymës ligjore, duke hapur vende pune të paligjshme.*

Sipas raportit të MAS nr. 2511/3, datë 09.05.2023 efektivisht dhe zyrtarisht duhet të ishin 14 mësues përfshirë dhe drejtorin, por në organikën e paligjshme janë paguar aktualisht 8 mësues më shumë. Pra buxhetit të shtetit de fakto i janë marrë në mënyrë korruptive me vende pune të panevojshme 8 dhe më shumë paga mujore për vitet mësimore 2014-2023.

Arsyeja e vetme që në mënyrë të paligjshme më kanë shkarkuar është sepse duan të mbyllin korrupsionin që i ka shkaktuar buxhetit të shtetit mbi 600 (gjashtëqind) milion lekë.

Përsa i takon argumentit të paraqitur nga DRAP Fier lidhur me pretendimin tim nr. 3 “Nuk më është dhënë mundësia të parashtraja pretendimet rreth raportit të monitorimit të MAS” mund të them se argumenti i përdorur nga DRAP Fier, sikur gjoja: “Ky pretendim nuk përfshin DRAP Fier sepse gjatë procedurës së zhvilluar nga ky institucion gjoja është respektuar plotësisht e drejta e ankueses për të shprehur pretendimet e saj”, mund të them se vendi ku unë duhej sipas procedurës të parashtraja pretendimet e mia lidhur me propozimin për largimin tim nga puna, duhet ti parashtraja pranë DRAP Fier me prezencë të domosdoshme edhe të përfaqësuesve të MAS, të cilët urdhëruan antiligjërisht DRAP Fier ti mbyllte gojën drejtueses së shkollës speciale duke e larguar atë nga puna dhe jo marrja e masave për shëndoshjen e gjendjes për ndëshkimin e

elementeve që kanë bërë veprime dhe mosveprime antiligjore duke regjistruar persona që nuk duhet të ishin regjistruar, duke shkaktuar hapjen e vendeve fiktive të punës dhe një dëm financiar.

Me Urdhrin nr. 60, datë 06.04.2023 për verifikim dhe vlerësimin e pretendimeve të ngritura në shkresën nr. 406, datë 03.04.2023 në lidhje me rastin e ndodhur në shkollë në datën 31.03.2023, në datën 12.04.2023 u krye monitorim në shkollën speciale, DRAP Fier NUK i ka vënë në dispozicion drejtorisë së shkollës speciale raportin me gjetjet dhe rekomandimet përsa i përket monitorimit të kryer në datë 12.04.2023, pavarësisht se citon aktin shkresor nr. 444/4/1 të dërguar pranë shkollës speciale. Këtë fakt e mbështet përsëri DRAP Fier me urdhrin nr. 77, datë 30.05.2023, nr. 580, “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e shkollës speciale Vlorë, mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin MAS”, DRAP Fier monitoron dhe harton raport monitorimi për shkollën speciale duke lënë dhe rekomandimet përkatëse përmes aktit shkresor nr. 580/3, datë 01.06.2023, vetëm mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin me nr. 2511/3, datë 09.05.2023 dërguar nga MAS. Kjo vërteton përsëri faktin se nga DRAP Fier NUK është nisur raport përsa i përket monitorimit të kryer datë 12.04.2023 nga grupi i punës i ngritur në bazë të Urdhrit nr. 77, datë 30.05.2023, i cili drejtohej nga G.B.

Theksoj faktin se G.B ka monitoruar në vijimësi shkollën speciale ku i ka evidentuar shkeljet e karakterit penal të kryera nga dy ish drejtoreshat A.I dhe E.K të pa ndëshkuara deri më sot. G.B në cilësinë e kryetares së Komisionit të Disiplinës të DRAP Fier ka bërë vendimmarrje ndaj meje edhe pse e ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit si person që ka qenë në dijeni të shkeljeve të karakterit penal të kryera nga ish drejtueset.

Nuk është pretendim, por është fakt lajmërimi që i kam bërë për humbjen e dokumentacionit shkollor, regjistra, ZVAP-së me datë 08.02.2023.

Përsa cituar nga DRAP Fier për klimën në institucion dhe mungesën e bashkëpunimit do u duhet tu sjell në vëmendje që ndër vite nga këta individë apo grup individësh kanë depozituar një sërë ankesash të pafundme si në ZVAP Vlorë, DRAP Fier, DPAP, të cilat janë pasqyruar nëpër raporte nga vetë këto institucione. Janë po këta individë që përbëjnë grupin ankues që me vetëdeklarimet e tyre të firmosura në procesverbalin e datës 26.10.2022 me nr. 07/1, datë 09.11.2022 kanë treguar kësajose cila ka qenë klima në institucion.

Duke iu referuar ankesave të depozituara ndaj meje, ishte detyrë e DRAP Fier për ti marrë në shqyrtim në komisionet e saj, Etikës dhe Sjelljes dhe më pas në Komisionin e Disiplinës”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 765/6, datë 20.09.2023 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 03.10.2023, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjektit ankues, E.L dhe përfaqësuesit ligjor³ Avokat K.C dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësueses me autorizim nr. 43445/3, datë 26.09.2023, të MAS, I.N, përfaqësueses me autorizim nr. 735/3, datë 28.09.2023 të DRAP Fier dhe autorizimin nr. 2221, datë 29.09.2023 të ZVAP Vlorë-Himarë, J.S.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të regjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime si në ankesën e paraqitur prej saj dhe prapësimëve të dërguara me shkresë, si dhe në mes të tjerash deklaroi se: *“Kur kam marrë detyrën ishte një mësuese që ishte dhe drejtore e komanduar dhe kam marrë regjistrat me procesverbal, të cilat dhe ajo vetë nga ish drejtoresha nuk i ka marrë me procesverbal sepse kishte refuzuar ti jepte. Regjistrat i kam marrë në dorëzim në datë 20.10.2022 dhe konstatova mungesë në shkurt 2023. Regjistrat e 3 viteve të fundit i mora me copë, ndërsa pjesën tjetër me procesverbal.*

Në datë 20.12.2022 i kam kthyer përgjigje ZVAP Vlorë, ku kam qenë duke shqyrtuar dy raste ankesash të prindërve kundër mësueseve. Ankesat ishin bërë në ZVAP Vlorë dhe ishin përcjellë nga data 12-13 dhjetor dhe më kërkohet që të shqyrtoja rastin sepse prindi ishte ankuar në ZVAP se mësuesja kërkonte të përfitonte ndihma nga një shoqatë. Në datë 28.12.2022 kam marrë një lajmërim nga ZVAP Vlorë që kërkonte të lajmëroja prindërit dhe mësuesit e shkollës të ishin prezent sepse do bëhej një intervistë. Grupi i punës ka ardhur dhe kanë bërë një pyetësor, pa më vënë në dijeni për rezultatet e pyetësorit. Pas pushimeve të janarit jam thërritur në DRAP Fier, ku më kanë kërkuar që të jap dorëheqjen, pasi i kam njohur për situatën në shkollë.

Në muajin prill 2023, MAS e ka thirrur në takim me Ministren dhe ankuesja e ka vënë në dijeni se ka bërë kallëzim penal dhe pas kësaj MAS ka dërguar një grup inspektimi, për të bërë një kontroll administrativ në shkollë”.

Nga ana e përfaqësueses së DRAP Fier dhe ZVAP Vlorë, u mbajt po ashtu i njëjti qëndrim si ai i komunikuar shkresërisht me Komisionerit, si dhe në mes të tjerash deklaroi⁴ se: *“Në datë 01.02.2023 një grup mësuesish ka paraqitur një ankesë në ZVAP Vlorë dhe ngrinin pretendime lidhur me funksionimin/mosfunksionimin e organeve kolegjiale në institucion, lidhur me pasqyrimin në listë prezencë të të dhënave të mësuesve apo me zhvillimin e mbjedhjeve të mësuesve nga drejtorja e shkollës. Nga shqyrtimi i ankesave ka rezultuar se komisioni i etikës dhe disiplinës kishin çështje që nuk vijonin të shqyrtoheshin, ndërkohë që në krye të komisionit është titullari i institucionit. Ka rezultuar se në listë prezencë firmosnin punonjësit dhe bazuar në listëprezencën e ZVAP Vlorë kishte diferenca dhe mangësi në ditë dhe kishte mangësi në regjistrimin e fëmijëve në klasë të parë.*

³ Referuar Prokurës së Përgjithshme nr. repertori 1629, nr. koleksioni 691, datë 23.06.2023 të Noterit E. N.I.

⁴ Referuar deklarimeve gjatë seancës dëgjimore, min 34.00 e në vazhdim.

Në datë 10.02.2023 ZVAP ka ngritur një grup pune për shqyrtimin e ankesës të dërguar me mesazh në datë 08.02.2023, në të cilën drejtorja e shkollës njofton për mungesë të regjistrave në shkollë”.

Nga ana e përfaqësueses së MAS, u mbajt po ashtu i njëjti qëndrim si ai i komunikuar shkresërisht me Komisionerit, si dhe në mes të tjerash deklaroi⁵ se: “Nuk ka një rregullore apo procedurë të shkruar lidhur me hartimin e raportit të grupit të punës të MAS. Grupi i punës mund të bëjë draft ose raport direkt por e vlerëson vetë, megjithëse drejtorja e shkollës ka pasur mundësinë të kundërshtojë raportin, por nuk e ka kundërshtuar. Drejtorja e shkollës kur ka parë se mësuesit nuk kanë ngarkesë mësimore, përse nuk ka marrë masa. Denoncimi është bërë vetëm për regjistrat dhe regjistrimet e fëmijëve dhe raporti ka evidentuar mangësi dhe për drejtueset e mëparshëm dhe aktual. Asnjë drejtor shkolle nuk i thotë ZVAP-së që do heq kaq mësues, por kur bie ngarkesa mësimore, drejtori fillon procedurën, nuk njofton ZVAP, por e bën vetë procedurën dhe njofton ZVAP, që ato mësues që ngelin pa ngarkesë, ti sistemojë”.

- Lidhur me trajtimin me sa më objektivitet të çështjes, si dhe në respektim të parimit të procesit të rregullt ligjor, Komisioneri nëpërmjet e-mailit të datës 03.10.2023, njohu palët me parashtrimet e depozituara gjatë seancës, respektivisht, si dhe me procesverbalin e mbajtur gjatë seancës.

Në vijim, subjekti ankues me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 765/7, datë 10.10.2023, dërgoi pretendimet e saj dhe në mes të tjerash informoi se: “Ankuesja është bërë pjesë e sistemit arsimor në vitin 2015 duke plotësuar të gjitha kriteret që parashikonte ligji për tu bërë pjesë e arsimit parauniversitar. Fillimisht është caktuar si mësuese pranë shkollës “Avni Rustemi” Vlorë, punë që e ushtroi deri në tetor 2022. Në muajin shtator DRAP Fier dhe ZVAP Vlorë, njoftoi hapjen e konkursit për drejtues të shkollës speciale Vlorë. Ankuesja aplikoi për drejtuese dhe fitoi, dhe në datë 17.10.2022 mori emërimin.

Pasi mori në administrim dokumentacionin dhe nisi punën, konstatoi se dokumentacioni ligjor si, regjistrat e nxënësve, apo numri fiktiv, si dhe mashtrimi që ishte bërë ndër vite prindërve të ndryshëm për fëmijët e tyre duke anashkaluar ligjin apo shkelur atë në kuptimin e organizimit dhe funksionimit të shkollës, duke e paraqitur atë si shkollë për të varfër dhe jo shkollë për fëmijët me zhvillim të vonët, kanë qenë mashtrimet më të rënda deri në abuzim.

Pas konstatimit të këtyre shkeljeve që ishin të natyrës penale, ankuesja i adreson këto shkelje si tek ZVAP Vlorë ashtu edhe tek DRAP Fier, por çuditërisht asnjë prej tyre nuk tregoi interes për shkeljet e gjetura.

Në këto kushte kur tashmë ishte ezauruar rruga denoncimit administrativ dhe ankuesja kuptoi se shkeljet e evidentuara në shkollën “Speciale” të karakterit penal në bazë të ligjit procedural penal që detyron çdo individ, apo zyrtar të denoncojë pranë organeve kompetente ato dhe nisur

⁵ Referuar deklarimeve gjatë seancës dëgjimore, min 01.00.10 e në vazhdim.

nga ky detyrim ligjor, drejtoresha E.L shkoi pranë Zyrës së Krimit Ekonomik dhe denoncoi ato, ndërkohë që çështja iu referua Prokurorisë së Rrethit Vlorë nga ku prej muajit Mars 2023 ka regjistruar procedimin penal dhe vazhdon hetimet.

Në këtë denoncim të saj u përfshinë si ish drejtueset e mëparshme të shkollës “Speciale”, A.I dhe E.K, drejtuesja e ZVAP Vlorë, I.T, si dhe drejtoresha e DRAP Fier, F.M.

Ky veprim i drejtoreshës së shkollës speciale, bëri që personat e akuzuar, A.I dhe E.K, si ish drejtuese të shkollës, I.T si drejtuese e arsimit vendor Vlorë, por mbi të gjitha Drejtoresha e DRAP Fier, F.M, nisën fushatën kërcënuese, diskriminuese ndaj ankueses. Këto kërcënime dhe diskriminim ishin të orientuara në disa drejtime:

- Duke detyruar prindërit e fëmijëve të bëjnë ankesa ndaj drejtoreshës së shkollës E.L, që kjo nuk ishte e aftë të menaxhonte punën pasi mësuesit kishin trysni dhe kjo reflektonte te fëmijët.
- Apo ankesa nga stafi pedagogjik drejtuar si ZVAP Vlorë dhe DRAP Fier, ku shprehin indinjatën e tyre për mungesën e etikës nga drejtuesja e shkollës.

Ankesat e pabaza deri në shpifje dhe fyerje kundër drejtoreshës së shkollës iu drejtuan edhe Ministres së Arsimit dhe Sporteve, e cila nga gjithë këto ankesa u shqetësua dhe në muajin prill të vitit 2023 kërkoi një ballafaqim me palët në ambientet e MAS Tiranë.

Pas takimit me palët, MAS urdhëroi ngritjen e një grupi monitorimi, me qëllim inspektimin e shkollës, i cili shkoi pranë shkollës dhe inspektoi gjendjen duke pyetur edhe palët ankuese për pretendimet e tyre.

Inspektorët e MAS pasi verifikuan pikat e ankesës, dolën me një raport përfundimtar të pandryshueshëm, pa u dhënë mundësi palëve të njiheshin me draft raportin me qëllim të bënin objeksionet e tyre lidhur me gjetjet, shkeljet dhe problematikat e tjera të evidentuara.

Ja disa prej tyre:

1. Zhdukjen e regjistrave, ku pasqyrohet e gjithë dinamika e punës së këtij institucioni.
2. Manipulimin e AMZA, nxënës të cilët duhet të ishin pjesë e shkollës, por që në fakt rezultonin jashtë vendit.
3. Manipulimin me nxënësit, të cilët gjenden të regjistruar në këtë shkollë, njëkohësisht gjendeshin edhe në shkolla të tjera të qytetit.
4. Fiktiviteti me nxënësit ka qenë dhe vazhdon të jetë arsye për të mbajtur hapur klasat dhe në këtë mënyrë marrin pagën mësueset.
5. Përfitimi financiar dhe ushqimor, si nga Bashkia Vlorë ashtu edhe nga donatorë, duke prezantuar numër nxënësish fiktivë dhe përfitimet u shkonin drejtueseve dhe mësueseve të shkollës speciale.

Këto dhe shumë shkelje të tjera u gjeten nga Kontrolli i MAS. Por çuditërisht në përfundim të auditit inspektorët në raport të gjitha këto gjetje ia ngarkuan drejtoreshës E.L, që në fakt kishte vetëm disa muaj në detyrë, kur ishte pikërisht kjo që kishte denoncuar dhe kishte kryer edhe kallëzim penal në Prokurorinë e Vlorës.

Në fakt raporti i inspektorëve të MAS ishte i njëjti me raportet e mëparshme nisur nga ai i vitit 2020, që nënkupton se shkeljet e gjetura apo konstatuara ishin të mbartura prej vitesh, por çuditërisht grupi i monitorimit më parë nuk i kishte adresuar këto gjetje pranë organeve ligjzbatuese, ashtu si bëri drejtuesja e shkollës speciale kur i konstatoi ato.

Grupi i monitorimit të MAS, në shkelje të ligjit i rekomandonte DRAP Fier marrjen e masave deri në largim nga puna, për drejtuesen e shkollës speciale E.L! Ky Raport ishte tërësisht i redaktuar mbi fakte që nuk qëndronin pasi çdo pretendim dhe shkelje të konstatuara dhe cituara në të, nuk janë kryer nga drejtuesja E.L por, janë bërë nga paraardhësit e saj, që çuditërisht kanë dhënë dorëheqjen me pretendimin e arsyeve familjare por që vazhdojnë të jenë mësuese në këtë institucion dhe përkatësisht A.I dhe E.K.

Me Vendimin nr. 40, datë 16.06.2023, DRAP Fier njofton drejtuesen E.L “Për zgjidhjen e justifikuar të Kontratës së Punës për pozicionin e drejtorit të shkollës speciale Vlorë”.

Ky vendim është i pabazuar sepse, është tërësisht i pa mbështetur në prova dhe natyrisht në ligj. Drejtueses së shkarkuar tashmë në cilësinë e ankueses, nuk i është vënë në dispozicion fizikisht asnjë shkelje dhe nuk i është komunikuar verbalisht asnjë problematikë të shkaktuar prej saj si drejtuese në këtë shkollë.

Në arsyetimin për largimin nga puna të ish drejtueses E.L, Komisioni i Disiplinës i ka rekomanduar drejtueses së DRAP Fier, “...se largimi duhet bërë pasi drejtuesja ka shkelje të rënda dhe të vazhdueshme të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni i punës sipas kontratës, të cilat vijnë të kenë pasoja për mirëqenien dhe sigurinë e nxënësve në institucionin arsimor parauniversitar që drejton si edhe për funksionimin në tërësi të atij institucioni”.

Gjithashtu komisioni i disiplinës pretendon se ka konstatuar edhe problematika se shkeljet e vërejtura nga grupi monitorimit të MAS në lidhje me kryerjen e detyrave dhe funksioneve zyrtare të drejtueses së shkollës, të pakontestuara nga ana e saj, përbëjnë parregullsi dhe dobësi të theksuara në menaxhimin e institucionit arsimor parauniversitar.

Komisioni i disiplinës gjykon se masa disiplinore të rezervuara për komisionin e disiplinës janë të pamjaftueshme për këtë rast dhe i sugjeron DRAP Fier të vijojë me procedimin disiplinor të drejtueses së shkollës speciale Vlorë, mbështetur në pikën 1/b, të shkronjës “B” të kreut të dytë në Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar, pika 16-3 germa “f” të nenit 16 të Kontratës Kolektive të punës të nënshkruar ndërmjet Ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe sindikatave të sektorit të arsimit.

Ju cituam arsyet e largimit nga puna të drejtueses E.L për të kuptuar se, asnjë prej tyre nuk qëndron për faktin se:

- 1. Në pikën e parë të arsytimit të largimit nga puna rekomandohet se: largimi si drejtuese duhet bërë për shkak se, ka patur shkelje të rënda dhe të vazhdueshme për mirëqenien dhe sigurinë e nxënësve në institucion nga drejtuesja E.L.*

Ky pretendim është tërësisht i pabazuar në prova, dhe në asnjë moment nuk ka patur abuzim apo shkelje të asnjë lloji nga drejtuesja E.L, për gjithë periudhën 5 mujore në drejtim të këtij institucioni. Është tërësisht abuzive të ngresh të tilla akuza kaq të rënda. Është shumë e thjeshtë të përdorësh akuzat pa asnjë provë shkresore, por edhe ankesa verbale, qofshin nga nxënësit por edhe nga prindërit. Po, është i vërtetë fakti që disa mësuese të kësaj shkolle janë shqetësuar për gjetjet e bëra ndaj tyre, ku konstatohen shkeljet dhe abuzimet, që në fakt janë konstatuar prej vitit 2020 nga grupi kontrollit DRAP Fier, dhe që nuk është marrë asnjë masë ndaj tyre, por këto shkelje janë anashkaluar me qëllimin e vetëm, mbulimin e tyre. U desh të vinte drejtuesja E. L që të kryente një kallëzim penal në prokurorinë e Vlorës për të gjitha këto manipulime dhe falsifikime.

- 2. Në vijim të arsytimit të tyre Komisioni i Disiplinës i sugjeron DRAP Fier të vijojë me procedimin disiplinor të drejtueses së shkollës “Speciale” Vlorë, mbështetur në pikën 1/b, të shkronjës “B” të kreut të dytë në Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar, pika 16-3 germa “f” të nenit 16 të Kontratës kolektive të punës të nënshkruar ndërmjet Ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe sindikatave të sektorit të arsimit.*

Edhe ky arsyetim i komisionit disiplinës nuk qëndron sepse, duke qenë të vetëdijshëm se drejtuesja E.L nuk kishte kryer asnjë shkelje sipas parashikimeve të ligjit për ta larguar nga detyra, sepse neni 106 i Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020, përcakton qartë se kur ndaj drejtuesit të institucionit duhet të merret masa e largimit nga puna, “Vetëm kur ushtrohet dhunë ndaj nxënësve dhe personelit, dhe kur kjo është e provuar me prova dhe fakte të pakundërshtueshme”, si kundër edhe në Udhëzimin nr. 2, datë 09.02.2022 ku është përcaktuar qartë se largimi i drejtuesit merret kur ai ka marrë dy vlerësime dobët të njëpasnjëshme. Duke qenë se, ligji dhe udhëzimet nuk kishin hapësira për ta shkarkuar, komisioni i disiplinës nga ku i mbetet vetëm një mundësi: Kontrata Kolektive e Punës e lidhur midis sindikatës dhe MAS. Në nenin 16 të kontratës germa “f” ku përcakton rastet e largimit nga puna, pika 16-4 cilësohet: “Në raste të thyerjes së rëndë të etikës në punë dhe të sjelljeve ekstreme të padenja nga ana e punëmarrësit, mund të bëhet zgjidhja e menjëhershme e kontratës individuale të punës, sipas parashikimeve të nenit 153 të Kodit të Punës”.

Në respekt të kësaj dispozite duket që Komisioni Disiplinës nuk arriti të faktoj këto shkelje. Thënë ndryshe, janë pretendime të fabrikuara vetëm e vetëm për të justifikuar veprimin arbitrar të largimit të pajustificuar nga puna të drejtueses së shkollës “Speciale” E.L.

Komisioni Disiplinës arsyetimin e tij e bazon mbi kontratën kolektive të punës të lidhur ndërmjet sindikatës së arsimit dhe MAS, por këtu përsëri gabon sepse, ankuesja E.L kur mori emërimin si drejtuese e shkollës, nuk ishte më pjesë e kësaj kontrate, por kishte një tjetër marrëdhënie juridike individuale me DRAP Fier, pasi aty kishte rolin e drejtueses dhe jo mësueses së thjeshtë. Pra çdo veprim dhe vendim i marrë nga Komisioni Disiplinës dhe DRAP Fier ndaj E.L është në kundërshtim me urdhëresat, e ligjin për arsimin parauniversitar dhe Kodin e Punës.

Gjithashtu, në Vendimin nr. 40, datë 16.06.2023 të largimit nga puna DRAP Fier thuhet se: “Zgjidh Kontratën e Punës për pozicionin e Drejtorit të Shkollës Speciale Vlorë”, të E.L, por nuk sqaron faktin pse ajo nuk duhet të qëndrojë në sistemin arsimor?

Në fakt arsyet e vërteta të largimit të menjëhershëm nga puna ishin të tjera, ishin arsye hakmarrje për kallëzimin penal të bërë nga shtetasja E.L, pranë prokurorisë ndaj personave përgjegjës që kishin mashtruar dhe shpërdoruar detyrën, që në fakt Drejtoresha e DRAP Fier, F.M ishte në dijeni të plotë të të gjitha veprimeve antiligjore prej vitit 2020, nga raportet e monitorimit që janë kryer pranë kësaj shkolle.

Duke qenë se përgjegjësia për veprimet e jashtëligjshme të gjetura në shkollën speciale bien direkt mbi drejtuesen e DRAP Fier, sepse nuk ka marrë masa për rregullimin e gjendjes së paligjshme, por e ka fshehur atë me qëllim dhe vendosi të hakmerret duke diskriminuar në mënyrë direkte drejtoreshën e shkollës E.L.

Drejtoresha në dijeni të plotë për veprimet dhe gjendjen e paligjshme në institucionin e shkollës speciale Vlorë, fakt ky që provohet nga raportet e monitorimit nisur nga viti 2020, ku ish drejtuesit e asaj kohe u detyruan të dorëhiqen për të njëjtat akuza dhe nuk u larguan nga puna, por qëndruan si mësuese pranë këtij institucioni, gjithashtu për një të tjerë prej tyre E.K, e dorëhequr në 29.01.2021 (ka ushtruar detyrën e drejtorit edhe 5 muaj të tjerë pas konstatimit të shkeljeve, referuar raportit 2020) është cilësuar në raport nga vetë grupi monitorimit se: dorëheqja e saj dhe punësimi pranë këtij institucioni si mësuese është bërë në kundërshtim me ligjin, pasi nuk kishte vend të lirë për mësuese në momentin kur dha dorëheqjen si drejtuese.

Pra, edhe pse kjo zonjë ishte kapur në shkelje të rënda me dëm në buxhetin e shtetit përsëri Drejtoresha e DRAP Fier, jo që nuk mori asnjë masë disiplinore, dhe as nuk e denoncoi për shpërdorim detyre por e favorizoi atë duke e sistemuar pranë këtij institucioni në vendin e mësueses, edhe pse në këtë institucion nuk kishte vend të lirë për mësuese.

Pyetja është: Drejtoresha e DRAP Fier, përse nuk ka ndjekur të njëjtin standard me të gjithë drejtuesit? Përse për zonjën E.L mori vendim për largim nga pozicioni titullarit dhe nxjerrjen e saj jashtë sistemit arsimor?

Kjo vërteton sjelljen diskriminuuese, që në fakt ka ardhur si pasojë e veprimeve denoncuese të drejtueses E.L pranë organeve ligjzbatuese për abuzimet e ndodhura ndër vite në institucionin e shkollës speciale Vlorë. Me këtë veprim, largimin si drejtuese dhe nga sistemi arsimor e ka bërë për të zhdukur gjurmët dhe mbyllur njëherë e përgjithmonë këtë çështje ku vet drejtuesja e DRAP Fier është përgjegjëse.

Gjatë seancës dëgjimore palët parashtruan pretendimet e tyre, ku ankuesja E.L edhe njëherë vërtetoi me prova se ishte larguar nga posti drejtueses dhe nga sistemi arsimor për shkak të denoncimeve të saj.

Në këtë seancë dëgjimore përfaqësuesit e DRAP Fier, ZVAP Vlorë dhe MAS nuk kishin asnjë vërejtje lidhur me gjetjet e raportit të monitorimit, por justifikimi i vetëm i tyre është fakti se drejtuesja E.L kur mori detyrën regjistrat ishin aty dhe kanë humbur gjatë ushtrimit të detyrës prej saj, por ky pretendim nuk u provua, sepse si DRAP Fier, ashtu edhe ZVAP Vlorë nuk e justifikonin, pasi regjistrat e humbur dhe gjithë problematikat e denoncuar nga drejtuesja E.L ishin objekt edhe i raporteve të mëparshme të vlerësimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), DRAP Fier dhe ZVA Vlorë-Himarë”.

Në vijim të shqyrtimit të çështjes, pas zhvillimit të seancës dëgjimore, DRAP Fier me shkresën nr. 1083, datë 09.10.2023, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Së pari, në lidhje me: “A ka patur raste të ngjashme për drejtues të institucioneve arsimore të cilat kanë kryer shkelje si ato të ankueses, për të cilat është marrë masa e largimit nga puna. Drejtueset e mëparshme sipas ankueses kanë kryer po të njëjtat shkelje të paraqitura në raportin e 2020 nga DPAP dhe 2021 nga DRAP Fier dhe për to nuk është marrë masa e largimit nga puna”, sqarojmë se DRAP Fier ka shqyrtuar raste të ngjashme me shkeljet e konstatuara në raportin nr. 2511/2, datë 08.05.2023, dërguar nga MAS. Bashkëlidhur po ju përcjellim vendimet mbështetur në Kreun B, pika 1, shkronja b, të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar ku citohet se: “Pas rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për inspektimin, sigurimin e cilësisë, vlerësimin, menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të arsimit parauniversitar, për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për parregullsi ose dobësi të theksuara në menaxhimin e IPAP”.

Së dyti, në lidhje me pyetjen: “Përse ankuesja nuk u sistemua në pozicionin e mësuesit dhe pse nuk u morën masa në mënyrë të përshkallëzuar?” sqarojmë se në zbatim të Kreut 12, pika 4, të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit dhe të mësuesit në dispozicion nga një vend pune, si dhe administrimi i portalit

“Mësues për Shqipërinë”, të ndryshuar, citohet se: “Drejtuesit e DRAP-ve nuk mund të pranojnë dorëheqjet e drejtorëve dhe nëndrejtorëve të institucioneve arsimore parauniversitare, pa i sistemuar më parë në vende pune të lira dhe me ngarkesë të plotë, brenda të njëjtës ZVAP-je, me përjashtim të rasteve kur drejtorët apo nëndrejtorët largohen nga sistemi arsimor sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk kanë 5 (pesë) vite përvojë pune si drejtor/nëndrejtor apo mësues, apo nuk plotësojnë kriteret ligjore për të qenë mësues. Rastet e dorëheqjeve të drejtorëve dhe nëndrejtorëve të IA-ve me kërkesën për sistemim si mësues. i paraqiten menjëherë komisionit të lëvizjeve paralele në ZVAP, gjatë apo ndërmjet viteve shkollore. Komisioni i paraqet kërkesat drejtorit të institucionit arsimor ku lirohet vendi më i parë i punës. Drejtorët dhe nëndrejtorët që kanë paraqitur kërkesën për dorëheqje, nuk mund të refuzojnë më shumë se 3 (tri) vende pune si mësues. të propozuara nga komisioni dhe emërimi u bëhet pa afat nga drejtori i IAP-së përkatëse”. Në kuptim të kësaj dispozite ligjore ju informojmë se E.L në asnjë moment nuk ka kërkuar apo paraqitur pranë DRAP Fier dorëheqjen dhe sistemimin e saj si mësuese. Gjithashtu në lidhje me “pse nuk u morën masa në mënyrë të përshkallëzuar”, sqarojmë se në raportin e ardhur nga MAS, tek rekomandime, kërkohet propozim për masë disiplinore për mangësi të theksuara në realizimin e detyrës, për organizimin dhe menaxhimin joefektiv të institucionit dhe në zbatim të Kreut B, rastet e shkarkimit dhe pezullimi i drejtorit të IPAP, pika 1, shkronja b, të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar ku citohet se: “Pas rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për inspektimin, sigurimin e cilësisë, vlerësimin, menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të arsimit parauniversitar, për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për parregullsi ose dobësi të theksuara në menaxhimin e IPAP”. Për sa më sipër referuar rekomandimit të lënë në raportin e sipërcituar, nuk jemi në kushtet e gjykimit të nenit 106, të Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e Rregullores për funksionimin e IA parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku citohet se: “Komisioni i disiplinës në DRAP vendos masën disiplinore për drejtorin e institucionit, kur konstaton:

- a) shkelje të dispozitave të Kodit të Punës, ose të LAPU-së, të akteve të tjera nënligjore dhe të rregullores;
- b) shkelje të etikës e të sjelljes në institucion;
- c) moskryerje të detyrave, sipas përshkrimit të punës;
- ç) përsëritje të rezultateve të ulëta të shkollës në provimet kombëtare.

3. Masat që komisioni i disiplinës vendos për drejtorin, janë:

- a) qortim; b) vërejtje; c) paralajmërim për largim nga puna.

Për shkeljen e parashikuar në raportin e sipërcituar, Komisioni i Disiplinës nuk mund të aplikonte masë administrative dhe rastin e ka referuar te titullari i DRAP Fier, referuar procesverbalit të mbajtur gjatë dëgjësës së E.L në Komisionin e Disiplinës. Gjatë zhvillimit të kësaj seance dëgjimore E.L ka pranuar gjetjet e konstatuara nga grupi i punës dhe nuk ka

kundërshtuar këtë raport në MAS edhe pse çdo akt administrativ është i kundërshtueshëm nga palët dhe në mbështetje të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ka afat ankimimi.

Së treti, në lidhje me pyetjen “...nëse për marrjen e masës së zgjidhjes së marrëdhënies së punës është mbajtur parasysh vetëm raporti 2511/2 i MAS apo edhe shkeljet në vijimësi që pretendohen nga punëdhënësi? ... sqarojmë se në dëgjuesën e datës 12.06.2023, me nr. 615, me titullarin e DRAP Fier, janë diskutuar gjetjet e raportit të MAS me nr. 2511/2, datë 08.05.2023 si dhe mbi gjetjet e raporteve të ZVAP Vlorë-Himarë me nr. 3002/1, datë 28.12.2022, me qëllim “Vlerësimi i klimës në shkollën speciale, Vlorë”; raporti i DRAP Fier, me nr. 590/2, datë 08.06.2023 me qëllim “Verifikimi i ankesës së mësueses S.B për ushtrim dhune në institucionin PLM”. Nga raportet e sipërcituara vihet në dukje se nuk ka frymë bashkëpunimi midis mësueseve dhe drejtueses së institucionit, E.L si dhe mungesë e theksuar e bazës ligjore për menaxhimin e institucionit. Gjatë dëgjuesës E.L ka shprehur se: “... nuk më sollën draft raport dhe nuk pata mundësi kontestimi ...”, fakt ky i përsëritur i cili do t'i shërbente E.L si mbrojtje apo si ankimim të përfundimeve të arritura në këto raporte, referuar Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Së katërti, në lidhje me: “Duhet të vërtetohet se në rastin konkret, për të njëjtat shkelje, paditësja është trajtuar në mënyrë të barabartë para ligjit, si drejtueset paraardhëse ose të vërtetohet se ankuesja dhe drejtueset paraardhëse nuk kanë qenë në të njëjtat pozita dhe rrethana”, sqarojmë se DRAP është krijuar në zbatim të VKM nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar” dhe ka funksionuar nga data 19.05.2019.

Në këtë periudhë drejtore në shkollën speciale, Vlorë ka qenë në detyrë si drejtuese e shkollës E.K, e emëruar me datë 24.01.2018 nga ish DAR Vlorë, sot ZVAP Vlorë-Himarë, e DRAP Fier ka monitoruar për herë të parë shkollën speciale për shqyrtimin dhe verifikimin e ankesës së mësueses A.B. Referuar gjetjeve është rekomanduar marrja e masës administrative për shkeljet ligjore të konstatuara në IAP. Në datën 29.01.2021 drejtuesja e shkollës E.K largohet me dorëheqje nga detyra, në mbështetje të Udhëzimit nr. 13, datë 22.5.2019 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, pra sqarojmë se E.L asnjëherë nuk ka kërkuar dorëheqje dhe sistemim si mësuese. Në lidhje me rastet e drejtuesve të mëparshëm sqarojmë se i përkasin si vendimmarrje ish DAR Vlorë”.

Në përgjigje të informacionit të dërguar nga DRAP Fier, ankuesja me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 765/9, datë 17.10.2023, në mes të tjerash informoi se: “1. Në lidhje me: “A ka patur raste të ngjashme për drejtues të institucioneve arsimore të cilat kanë kryer shkelje si ato të ankueses, për të cilat është marrë masa e largimit nga puna, duke iu referuar ankueses,

pasi nga raportet e mëparshme rezulton se edhe drejtueset e mëparshme kanë kryer të njëjtat shkelje”.

Lidhur me këtë DRAP Fier ka vendosur institucionit Tuaj edhe raste analoge të drejtueseve të larguara, ndërkohë që nuk ka emra konkret.

Përgjigje: Përsa i përket kësaj pyetje, ju sjellim në vëmendje se, institucioni DRAP Fier me shkresën nr. 735/1, datë 14.07.2023 ka informuar KMD se: “përsa i përket informacionit mbi monitorime nga MAS edhe në shkolla të tjera, për shkelje të ngjashme, DRAP Fier nuk ka dijeni mbi monitorime të tjera të ministrisë gjithashtu në vijim, përsa i përket informacionit mbi masat disiplinore për drejtues të tjerë, për të njëjtat shkelje si ankuesja, ju informojmë se nuk ka pasur raste të ngjashme.....”.

- 1. Në lidhje me pyetjen “se përse ankuesja nuk u sistemua në pozicionin e mësuesit, dhe pse nuk u morën masa në mënyrë të përshkallëzuar?”*

Pretendimi i DRAP Fier lidhur me këtë pyetje është sepse E.L në kuptim të dispozitave ligjore nuk paska kërkuar apo paraqitur pranë DRAP Fier dorëheqjen dhe sistemimin e saj si mësuese.

Ky pretendim i DRAP Fier nuk qëndron sepse, largimi nga detyra i drejtueses së institucionit ishte i menjëhershëm. Funkzioni i drejtuesit s'ka lidhje me atë të mësuesit, gjithashtu ky pretendim nuk qëndron për shumë arsye ligjore. Largimi i E.L është bërë në mënyrë të menjëhershme, dhe sikur të ndodhte ndryshe, zonja nuk mund të bënte një veprim të tillë, sepse nëse do ta bënte këtë veprim do pranonte fajësinë dhe çdo denoncim i saj që kishte bërë deri në atë moment do t'i kthehej në pranim fajësie.

Gjithashtu E.L është drejtuar me kërkesë edhe MAS-it ku i ka kërkuar revokimin e vendimit për largimin nga detyra, gjithashtu nëse kjo ishte e pamundur ta sistemonim në vendin e mëparshëm të punës si mësuese, pasi ajo ka edhe licencën e mësuesit që nënkupton plotëson të gjitha kushtet ligjore për të qenë brenda sistemit arsimor.

Në lidhje me pyetjen “Përse nuk u morën masa në mënyrë të përshkallëzuar” DRAP Fier pretendon se E.L i ka pranuar shkeljet në institucionin shkolla speciale. Ky është një keqinterpretim me dashje nga DRAP Fier. E.L vërtet i ka pranuar shkeljet e gjetura nga grupi monitorimit MAS, sepse po kjo drejtuese kishte bërë që prej muajit mars 2023 edhe kallëzim penal në organin e prokurorisë për këto shkelje sepse, shkeljet ishin aty prej vitesh dhe në fakt ishin mohuar nga DRAP Fier dhe ZVAP Vlorë.

Këto shkelje janë të vërtetuara edhe nga raportet e monitorimit MAS për vitin 2020-2021-2022 që nënkupton se, E.L ka pranuar pikërisht këto shkelje të mbartura ndër vite.

- 2. Në lidhje me pyetjen, “... nëse për marrjen e masës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës është mbajtur parasysht vetëm raporti MAS 2511/2, apo edhe shkeljet në vijimësi që pretendohen nga punëdhënësi?” DRAP Fier sqaron se në dëgjuesën e datës*

12.06.2023 me nr. 615 me drejtuesen e DRAP Fier, janë diskutuar gjetjet e raportit të MAS me nr. 251112, datë 08.05.2023, si dhe mbi gjetjet e raporteve të ZVAP Vlorë me nr. 3002, datë 28.12.2022 me qëllim “Vlerësimi i klimës në shkollën “Speciale” Vlorë, raportin e DRAP Fier 590/2, datë 08.06.2023, me qëllim “Verifikimi i ankesës së mësueses S.B për ushtrim dhune në institucionin PLM”.

Përgjigje: Këto pretendime nuk qëndrojnë sepse, nuk janë diskutuar në asnjë moment ndërmjet drejtueses DRAP Fier dhe ankueses E.L. Këtë mund ta vërtetoni në procesverbalin e mbajtur në takim në DRAP Fier të E.L, sipas njoftimit të datës 05.06.2023. Këto nuk janë asgjë tjetër, veç justifikime dhe lojëra fjalësh, për të justifikuar veprimet e kundraligjshme të DRAP Fier dhe MAS ndaj ankueses. Pra, nuk mund tu përgjigjemi pretendimeve sajesa të DRAP Fier dhe asnjë dokumenti tjetër që ankuesja nuk është njohur dhe nuk është në dijeni dhe nuk i është vendosur në kohë, që të mund të kishte të drejtën për ankim. Çdo pretendim i ngritur nga DRAP Fier sot, por që ankuesja nuk është njohur më parë, është nul nga pikëpamja juridike. Për KMD po ju vëmë në dispozicion edhe kopje të procesverbalit të datës 12.06.2023 ku vërtetohet që nuk është ngritur asnjë pretendim nga këto që kanë dërguar si prapësime tek KMD.

3. Në lidhje me “ ... duhet të vërtetohet se në rastin konkret, për të njëjtat shkelje, ankuesja është trajtuar në mënyrë të barabartë përpara ligjit si drejtueset paraardhëse, ose të vërtetohet se ankuesja dhe drejtueset paraardhëse nuk kanë qenë në të njëjtat pozita dhe rrethana”.

Për këtë pyetje DRAP Fier i është referuar rastit të E.K, e cila është emëruar me 24 janar 2018 nga ish DAR Vlorë, sot ZVAP Vlorë-Himarë.

Këtë rast DRAP Fier kërkon ta paraqes si të njëjtë me ankuesen E.L, por që në fakt s'ka asnjë lidhje, pasi ish drejtuesja E.K është konstatuar me shkelje të rënda në drejtimin e institucionit dhe çuditërisht nuk është marrë asnjë masë disiplinore ndaj saj, edhe pse kishte kryer shpërdorim të detyrës që klasifikohet si dëm në buxhetin e shtetit dhe vepër penale.

Çuditërisht ndaj E.K jo vetëm që nuk është marrë asnjë masë disiplinore, por i është mundësuar ushtrimi detyrës si titullare edhe 5 muaj pas konstatimit të shkeljeve të rënda të detyrës. Pas afro 5 muajsh, zonja në fjalë i ka paraqitur DRAP Fier dorëheqjen, e cila është pranuar dhe po nga institucioni që në fakt duhet ta penalizonte i është mundësuar punësimi si mësuese pranë këtij institucioni shkolla speciale Vlorë, duke shkelur edhe ligjin, pasi në institucionin shkolla speciale nuk kishte vend të lirë për mësuese. (Ky veprim i DRAP Fier është gjetur si shkelje nga raporti monitorimit të MAS në shkollën speciale, me nr. 855/7, datë 29.06.2021).

Justifikimi i DRAP Fier se: për ish drejtueset vendimmarrja i përkiste DAR Vlorë nuk qëndron. Kontrolli apo raporti i monitorimit të MAS për vitin 2020 vërteton faktin se, ish drejtuesja e shkollës E.K ishte direkt nën varësinë e DRAP Fier dhe ZVAP Vlorë-Himarë. Nisur nga kjo

vërtetohet edhe njëherë fakti se DRAP Fier gjen justifikime deri në mashtrime për të hequr nga vetja përgjegjësinë. Pra dallohet qartë se trajtimi nuk ka qenë i njëjtë për rastet e sipërcituara.

Gjithsesi për E.L, nuk ka asnjë gjetje të shkëljes së ligjit përgjatë periudhës 6-mujore që ushtrori funksionin e drejtueses së shkollës.

Përsa më sipër, vërtetohet edhe njëherë fakti se E.L nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me rastet analoge. Kjo vërteton edhe njëherë se largimi nga detyra dhe përfundimisht nga sistemi arsimor është bërë për hakmarrje ndaj denoncimeve të saj për drejtuesit e institucionit si DRAP Fier ashtu edhe për ZVAP Vlorë-Himarë, por edhe MAS”.

Në vijim të shqyrtimit të çështjes, pas zhvillimit të seancës dëgjimore, ZVAP Vlorë me shkresën nr. 2098/1, datë 19.10.2023, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Në seancën dëgjimore u vu theksi të kronologjia e ngjarjeve, për rrjedhojë më poshtë sqarojmë dokumentacionin e vendosur në dispozicion, sipas rendit kronologjik.

1. Ankesat e mësueseve të shkollës Speciale ndaj E.L kanë filluar që në muajin dhjetor 2023 dhe konkretisht me ankesën e datës 14.12.2022 drejtuar DRAP Fier me anë të së cilës 9 (nëntë) mësuese të këtij institucioni arsimor ankohen për keqmenaxhim të institucionit arsimor, komunikim jo etik të drejtoreshës, trajtim jo të barabartë, etj.

Bazuar në ankesat e mësueseve të shkollës është kryer një vlerësim i klimës së krijuar në shkollën speciale, nga ku ka rezultuar se në shkollë ka problematika të shumta lidhur me marrëdhënien mësues-drejtues, mësues-mësues dhe prindër-mësues-drejtues, vërtetuar kjo me raportin e vlerësimit nr. 3002/1, datë 28.12.2022. Në raport shprehet qartë situata e krijuar në shkollë ku 50% e mësuesve shprehen se drejtoresha e shkollës nuk merr masa për zgjidhjen e problemeve në kohën e duhur, nuk trajton stafin njësoj, komunikon në mënyrë joetike, etj.

Ankesat e mësueseve ndaj drejtoreshës së shkollës kanë vijuar dhe në muajin janar 2023 ku në një takim të zhvilluar me drejtorin e ZVAP Vlorë në datën 11.01.2023 shprehin ankesa lidhur me mënyrën e drejtimit të IAP-së dhe mënyrën e komunikimit të drejtoreshës së shkollës.

Mësueset e shkollës në datën 01.02.2023 kanë vijuar ankesat e tyre ndaj E.L në një tjetër takim të zhvilluar me titullarin e ZVAP Vlorë. Në takimin e zhvilluar, mësueset u shprehën se pas ankesës së tyre në muajin janar 2023 një serë problematikash të tjera vijnë ende të pazgjidhura.

Ndër të tjera mësueset u ankuan për mosfunksionim të organeve kolegjiale të IAP-së, regjistrimin e nxënësve, pasqyrimin e mungesave të mësueseve në listëprezencë, etj. Bazuar në ankesat e ngritura nga mësueset e shkollës me Urdhrin nr. 18, datë 03.02.2023, ZVAP Vlorë

ngriti grup pune për shqyrtimin e tyre. Nga shqyrtimi i ankesave rezultoi se të gjitha problematikat e ngritura nga mësueset qëndronin.

Në datën 08.02.2023 E.L ka njoftuar nëpërmjet mesazhit me celular se në shkollë mungonin disa regjistra të cilëve nuk iu kishte mbaruar afati i ruajtjes në institucion. ZVAP Vlorë me Urdhrin nr. 20, datë 10.02.2023 ngriti grup pune për të kryer verifikimet përkatëse në IAP.

Rezultoi se në shkollë mungonin regjistra të cilët E.L i kishte marrë në dorëzim nga ish drejtoresha e shkollës me procesverbalin e datës 20.10.2022, mbajtur midis A.K ish drejtoreshë e shkollës dhe E.L, rezultonte se A.K kishte bërë dorëzimin e regjistrave të E.L.

Pra, regjistrat i kanë humbur E.L e cila në cilësinë e drejtorit të shkollës, ligjërisht kishte detyrimin të merrte masat e nevojshme për ruajtjen dhe sigurinë e dokumentacionit shkollor. Gjë të cilën nuk e ka bërë dhe pasoja ishte humbja e regjistrave.

Kreu XIX, neni 109, pika 1, 2 dhe 3 e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore përcakton rregullat e ruajtjes së regjistrave dhe personat që përgjigjen për ruajtjen e tyre. Konkretisht, në shkollën speciale duke qenë se nuk ka sekretari dhe as nëndrejtor, përgjegjësia për ruajtjen e tyre dhe përdorimin në përpunje me parashikimet ligjore ishte drejtpërdrejtë përgjegjësi e E.L.

E.L ka njoftuar vjedhjen e regjistrave vetëm pasi i është kërkuar nga ZVAP Vlorë, kur bazuar në nenin 113, pika 10, duhej të kishte njoftuar menjëherë policinë dhe bashkinë.

Në konkluzionet e dërguara shkollës me nr. 324/2, datë 22.02.2023 grupi i punës i ka kërkuar E.L raportimin e humbjes së regjistrave dhe verifikimin e ligjshmërisë së regjistrimit të nxënësve edhe në periudha të mëparshme.

E.L ka kryer veprimet për denoncimin e humbjes së regjistrave dhe regjistrimit të nxënësve, në organet përkatëse ligjore në datën 02.03.2023, bazuar në shkresën nr. 324/2, datë 22.02.2023 të ZVAP Vlorë.

Këtë gjë e ka shprehur dhe vetë E.L në kallëzimin e bërë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë të cilin e gjeni bashkëlidhur.

Gjithë rrjedha kronologjike e shpjeguar më lart, tregon qartësisht se ankesat e mësuesve dhe monitorimet e ZVAP Vlorë janë kryer përpara se E.L të kryente denoncimin në organet kompetente. Ankesat e mësuesve kanë qenë të vijueshme që në muajin dhjetor 2022 e deri në shkurt 2023, ndërkohë që E.L e ka kryer denoncimin në prokurori në muajin mars 2023, pra pas ankesave të mësuesve dhe pasi i është lënë rekomandim kryerja e denoncimit nga ZVAP Vlorë.

Nuk ka asnjë lidhje shkakësore mes denoncimit të E.L dhe ankesave të mësuesve apo monitorimeve të ZVAP Vlorë.

Nuk mund të pretendohet se largimi nga puna është kryer për shkak të denoncimit që ajo ka kryer, pasi denoncimi është kryer mbështetur në rekomandimet që grupi i monitorimit të ZVAP Vlorë ka lënë. Vetë ZVAP Vlorë ka kërkuar prej saj të përmbush detyrimet ligjore në cilësinë e titullarit të shkollës dhe të kryejë denoncimin në organet përkatëse ligjzbatuese. Në këto kushte E.L nuk mund të pretendoj zgjidhjen e marrëdhënies së punës nga DRAP Fier për shkak të denoncimit që ka kryer.

- 2. Pretendimi i E.L se për ish-drejtuesit e shkollës nuk është marrë masë largimi nga detyra për të njëjtat shkelje nuk qëndron, pasi nuk jemi para të njëjtave kushte dhe shkelje.*

Së pari, konkluzionet që kanë arritur grupet e punës në monitorime të mëparshme nuk janë të njëjta me ato të pasqyruara në raportin e monitorimit nr. 2511/2, datë 09.05.2023 të MAS.

Së dyti, masa merret në përputhje me rëndësinë e shkeljes së kryer dhe në rastin e E.L, DRAP Fier nuk e ka marrë vendimin të bazuar vetëm në raportin e monitorimit të MAS nr. 2511/2, datë 09.05.2023, por ka pasur parasysh gjithë situatat e krijuara në institucionin arsimor, ku drejtoresha ka krijuar një klimë jo bashkëpunuese, jo të përshtatshme e cila ka ndikuar drejtpërdrejt dhe të nxënësit e shkollës, reflektuar kjo në ankesat e paraqitura shpesh herë edhe nga prindërit e nxënësve.

Qëllimi kryesor i institucionit arsimor është sigurimi i cilësisë së mësimdhënies dhe në shkollën speciale gjatë periudhës së drejtimit të E.L ka rezultuar e provuar se klima në shkollë ka qenë e tillë që ka penguar realizimin e qëllimit kryesor të një institucioni arsimor.

Së treti, ligji 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, në nenin 55 pika, 5/c, i cili parashikon shkarkimin e drejtorit të IAP-së në rastet e parregullsi dhe keqmenaxhimit të shkollës:

Drejtori i IAP-së shkarkohet në rastet si më poshtë:

- Pas rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për inspektimin, sigurimin e cilësisë, vlerësimin, menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të arsimit parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për parregullsi ose dobësi të theksuara në menaxhimin e IAP-së;*

Së katërti, DRAP Fier për raste të ngjashme me E.L ka aplikuar të njëjtën masë disiplinore, atë të largimit nga puna.

Për të provuar këtë fakt, bashkëlidhim vendimet e DRAP Fier nr. 55, datë 29.09.2020, nr. 85, datë 23.11.2021 dhe nr. 86, datë 24.11.2021 për zgjidhje të marrëdhënies së punës me drejtues të tjerë të IAP-ve, për mungesë të menaxhimit të shkollave.

Së pesti, si për çdo punonjës të përfshirë në një procedurë disiplinore, E.L i është dhënë mundësia të dëgjohet dhe të mbrohet para vendimmarrjes.

Në këto kushte, nuk i është mohuar e drejta për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar duke e vendosur në kushte të barabarta me të gjithë punonjësit e tjerë në raste kur ndaj tyre zhvillohet procedurë disiplinore”.

Në përgjigje të informacionit të dërguar nga ZVAP Vlorë, ankuesja me e-mail-in datë 30.10.2023, në mes të tjerash informoi se:

“Së pari, theksojmë faktin se ZVAP Vlorë ashtu si dhe DRAP Fier e MAS, është përpjekur në çdo moment për të mbuluar përgjegjësinë institucionale që ka patur dhe ka, në lidhje me abuzimet që janë bërë në institucionin shkolla speciale. ZVAP Vlorë ka miratuar në fillim të vitit mësimor, në kundërshtim me Ligjin 69/2012, si dhe Urdhrin nr. 31 datë 28.01.2020, çdo dokument që zbatohet në shkollë, si dhe ngarkesat mësimore të mësuesve, të cilat u evidentuan si shkelje nga grupi i monitorimit i MAS, të paraqitura në raportin e monitorimit të ligjshmërisë institucionale për shkollën, duke iu referuar vitit mësimor 2019-2020 e në vazhdim, (monitorimi i përket një periudhe kohore 4 vjeçare), me nr. 2511/3, datë 09.05.2023, por që ishin denoncuar më parë nga E.L.

Së dyti, pretendimet e ZVAP Vlorë, për ushtrim dhune nga ana e E.L, nuk qëndrojnë, nuk janë të bazuara në prova dhe në fakte, sepse, në asnjë rast ZVAP Vlorë, nuk ka paraqitur kërkesë për procedim disiplinor “Për ushtrim dhune”, për E.L në DRAP Fier, e cila duhet të kishte ndërmarrë masën e shkarkimit të E.L qysh në muajin dhjetor, siç pretendon ZVAP, madje ta shoqëronte masën disiplinore edhe me ndjekje penale. Pra, kjo gjë nuk ka ndodhur.

Çdo pretendim i ngritur nga ZVAP Vlorë sot, por që ankuesja nuk është njohur më parë është nul nga pikëpamja juridike. Për KMD kemi vënë në dispozicion edhe kopje të procesverbalit të datës 12.06.2023 ku vërtetohet që nuk është ngritur asnjë pretendim nga këto që kanë dërguar si prapësime tek KMD.

Së treti, shkeljet në institucionin shkolla speciale, nuk janë konstatuar nga grupi i kontrollit të ZVAP Vlorë në muajin shkurt, siç shprehet në pretendimet e saj. ZVAP Vlorë e ka përgjegjësi institucionale, sepse i ka legjitimuar shkeljet duke i miratuar në fillim vitit mësimor, por ishte pikërisht E.L, që ia vuri në dukje gojarisht dhe shkresërisht ZVAP Vlorë shkeljet e konstatuara nga evidentimet e kryera, pas marrjes së detyrës në datën 17.10.2022. Kjo vërtetohet edhe nga shkresa e ZVAP Vlorë me nr. 324/2, datë 22.02.2023 “Dërgohen konkluzionet e grupit të punës” ku citojnë se:

“.....Sipas procesverbalit të mbajtur nga grupi i punës në shkollë për inventarizimin e regjistrave... “.

- Në lidhje me pretendimet e ngritura nga ju (E.L), gjatë takimit të zhvilluar në drejtori mbi ligjshmërinë e regjistrimit të nxënësve në periudha të mëparshme në institucionin tuaj arsimor, lutemi në përmbushjen e detyrimeve ligjore”.

Pra, ZVAP Vlorë ishte kapur në shkelje nga E.L, pasi edhe grupi monitorimit në rekomandimet e lëna në raportin nr. 2511/3, datë 09.05.2023, citon detyrimet ligjore për ZVAP-në, e cila referuar Ligjit 69/2012, si dhe Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 “Rregullores për Funkionimin e IAP në Republikën e Shqipërisë”, duhet të organizojë dhe të monitorojë vlerësimin e nxënësve me aftësi ndryshe. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, ZVAP të përcjellë zyrtarisht në shkollën speciale listën e nxënësve që plotësojnë kriteret ligjore për të vazhduar mësimet pranë këtij institucioni.

Theksoj faktin se nxënësit në shkollën speciale bazuar në legjislacion duhet të jenë nxënës që përfitojnë KMCAP, regjistrohesh me paraqitjen e kërkesës nga prindi, pasi kanë kaluar më parë në një proces vlerësimi në Komisionin Multidisiplinar, i cili ngrihet dhe monitorohet nga ZVAP.

Ky proces vlerësimi duhet të kryhet përpara nisjes së vitit të ri mësimor, sepse në varësi të numrit të nxënësve që regjistrohesh në shkollë, referuar udhëzimit përkatës të fillim vitit të MAS bëhet e mundur hapja e klasave, si dhe përcaktohet nevoja e institucionit arsimor për staf mësimor.

Pra, përgjegjësia institucionale e ZVAP Vlorë si edhe e DRAP Fier e MAS në veprimet abuzive të kryera në shkollën speciale është e pashmangshme.

E.L ndodhur përpara fakteve abuzuese në shkollë, denoncimin pranë organeve ligjzbatuese e kishte detyrim ligjor dhe jo një zbatim urdhri referuar shkresës nr. 324/2, siç pretendon ZVAP. I.T, në cilësinë e drejtueses së ZVAP-së, duhet të monitoronte dhe të mos lejonte abuzimet në shkollën speciale. ZVAP Vlorë, në çdo argument të saj, të parashtruar në aktin shkresor nr. 2058/1, datë 19.10.2023, përpiqet të justifikojë veprimet e kundraligjshme të kryera nga vetë ajo, por edhe të DRAP Fier dhe MAS.

Për E.L, nuk ka asnjë gjetje të shkeljes së ligjit përgjatë periudhës 6-mujore që ushtrroi funksionin e drejtueses së shkollës, që të përlligjte veprimin e DRAP Fier për largimin nga detyra si drejtuese, si dhe nxjerrjen jashtë sistemit arsimor.

Largimin nga detyra dhe përfundimisht nga sistemi arsimor i E.L, bazuar në raportin e monitorimit të grupit të MAS me nr. 2511/3, datë 09.05.2023, i cili monitoroi zbatimin e ligjshmërisë institucionale të shkollës, qysh nga viti mësimor 2019-2020 e në vazhdim, (pra për një periudhë 4 vjeçare) qartazi duket se është bërë për hakmarrje ndaj denoncimeve të saj pranë organeve ligjzbatuese për drejtuesit e institucionit si ZVAP Vlorë, ashtu edhe DRAP Fier, por edhe MAS”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “*‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij*”.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.*”, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankueses.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Referuar Librezës së Punës së E.L, rezulton se ka filluar punë si mësuese me afat të pacaktuar në shkollën “Avni Rustemi”, Vlorë në datë 15.09.2015. Me Vendimin nr. 131, datë 17.10.2022 “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, të DRAP Fier, është emëruar në pozicionin e drejtorit të shkollës “Speciale PLM” Vlorë-Himarë (në vijim shkolla speciale).

Ministria e Arsimit dhe Sportit me Urdhrin nr. 186, datë 14.04.2023, ka ngritur grupin e punës për monitorimin e veprimtarisë së shkollës speciale Vlorë. Në përfundim të monitorimit grupi i punës ka dalë me Raportin nr. 2511/2, datë 08.05.2023. Grupi i punës të MAS në përfundim të gjetjeve dhe rekomandimeve të lëna ka propozuar: “Mbështetur në pikat 2/a, ç dhe 3/a të nenit 54, të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 106, të kreut XVIII, të Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH”, dhe në paragrafin 15.3 të Kontratës Kolektive të Punës, DRAP Fier të fillojë procedurën disiplinore ndaj E.L, drejtor i shkollës speciale Vlorë, për mangësi të theksuara në realizimin e detyrës, për organizimin dhe menaxhimin joefektiv të institucionit”.

Në vijim të raportit të grupit të punës së MAS, DRAP Fier me shkresën nr. 444/2, datë 24.05.2023 ka dërguar raportin e MAS pranë Komisionit të Disiplinës të DRAP Fier, i cili ka zhvilluar një seancë dëgjimore me drejtoresh E.L në datë 29.05.2023.

Në pikën 6 të Vendimit nr. 577/1 prot, datë 01.06.2023, Komisioni i Disiplinës ka konstatuar se: “Komisioni i disiplinës konstaton se problematikat dhe shkeljet e vërejtura nga grupi i monitorimit i MAS, në lidhje me kryerjen e detyrave dhe funksioneve zyrtare të drejtores së shkollës E.L, të pakontestuara nga ana e saj, përbëjnë parregullsi dhe dobësi të theksuara në menaxhimin e institucionit arsimor parauniversitar. Komisioni i disiplinës gjykon se masat disiplinore të rezervuara për komisionin e disiplinës janë të pamjaftueshme për këtë rast” dhe për sa më sipër vendosi: “T’i rekomandojë drejtorit të DRAP Fier të vijojë me procedimin disiplinor të drejtores së shkollës speciale Vlorë, E.L, mbështetur në pikën 1/b të shkronjës “B” të kreut II të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar, në pikën 16.3, germa “f” të nenit 16 të Kontratës Kolektive të punës, të nënshkruar midis Ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe sindikatave të sektorit të arsimit”.

Në datë 12.06.2023, mes Drejtores së DRAP Fier dhe E.L është zhvilluar takimi dhe është mbajtur procesverbali, për të diskutuar mbi zgjidhjen e kontratës së punës mes palëve.

Me Vendimin nr. 40, datë 16.06.2023, “Për zgjidhjen për shkaqe të justifikuara të Kontratës së Punës me E.L, në pozicionin drejtor e shkollës speciale Vlorë”, DRAP Fier ka vendosur për zgjidhjen e kontratës së punës me E.L për shkelje të rënda të vazhdueshme të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni i punës sipas kontratës, të cilat vijojnë të kenë pasoja për mirëqenien dhe sigurinë e nxënësve në institucionin arsimor parauniversitar që drejton, si edhe për funksionimin në tërësi të atij institucioni.

Ankuesja pretendon se nuk ka asnjë gjetje të shkeljes së ligjit përgjatë periudhës 6-mujore që ushtrori funksionin e drejtueses së shkollës, që të përlligjte veprimin e DRAP Fier për largimin nga detyra si drejtuese, si dhe nxjerrjen jashtë sistemit arsimor dhe se largimi nga detyra, bazuar në raportin e monitorimit të grupit të MAS, qartazi duket se është bërë për hakmarrje ndaj denoncimeve të saj pranë organeve ligjzbatuese për drejtuesit e institucionit si ZVAP Vlorë, ashtu edhe DRAP Fier, por edhe MAS.

Komisioneri ka vlerësuar dhe analizuar objektin e kësaj ankese, lidhur me pretendimin e ankueses për largimin e saj nga puna si rezultat i denoncimit të saj të bërë në Prokurorinë Vlorë në datë 02.03.2023, lidhur me humbjen e dokumentacionit të shkollës dhe ligjshmërinë e regjistrimit të nxënësve në shkollë, *së pari*, duke analizuar nëse veprimet e ZVAP Vlorë dhe DRAP Fier janë të drejta dhe në përputhje me parashikimet ligjore, përsa i takon kontrollit dhe monitorimit të funksionimit të veprimtarisë në shkollën speciale Vlorë, *dhe së dyti*, nëse konstatohet një gjë e tillë, atëherë Komisioneri vlerëson, nëse ky trajtim lidhet apo jo, me shkakun e pretenduar nga subjekti ankues (kallëzimit të bërë në Prokurori).

A.1 Lidhur me procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës mes palëve.

Nga këqyrja e dokumentacionit, deklarimeve të palëve dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Një grup prej nëntë mësuesisht të shkollës speciale, në datë 14.12.2022 i janë drejtuar me një shkresë/ankesë DRAP Fier. Në mes të tjerash mësuesit ankohen se: *“Përmes kësaj ankese po ju drejtohem ju si organ vendimmarrës, pasi i jemi drejtuar komisionit të etikës dhe sjelljes në shkollë, në lidhje me aspekte të menaxhimit dhe komunikimit institucional që drejtuesja E.L zbaton gjatë punës në shkollë”*. Më poshtë kanë renditur 17 pika dhe në fund informojnë se: *“Na vjen shumë keq që në kaq pak kohë E.L ka shfaqur mungesë komunikimi, frymë mosbashkëpunimi, klimë konfliktuale dhe zhvëlsim të figurës së mësuesit në shkollë”*.

DRAP Fier me e-mail-in datë 21.12.2023, ka njoftuar dhe ka kërkuar nga ZVAP Vlorë trajtimin e ankesës.

ZVAP Vlorë me Urdhrin nr. 97, datë 22.12.2022 ka ngritur grupin e punës për trajtimin e ankesës. Grupi i punës ka zhvilluar vlerësimin duke marrë të dhënat nëpërmjet pyetësorëve me mësuesit (20 mësues nga 22 gjithsej) dhe pyetësorëve me prindër (29 prindër, rreth 50%) dhe me shkresën nr. 3002/1, datë 28.12.2022, ka hartuar raportin e vlerësimit dhe në përfundim ka sugjeruar se: *“DRAP Fier të zhvillojë një inspektim në këtë shkollë lidhur me problematikat e ngritura nga mësuesit dhe komuniteti i prindërve”*.

Referuar procesverbalit nr. 117, datë 11.01.2023, rezulton se në datë 11.01.2023 mes Drejtorit të ZVAP Vlorë dhe një grupi prej nëntë mësuesish të shkollës speciale, është zhvilluar një takim në të cilin mësuesit kanë paraqitur ankesë mbi mënyrën e drejtimit të institucionit arsimor nga ana e drejtores E.L.

Referuar procesverbalit nr. 204, datë 01.02.2023, rezulton se në datë 01.02.2023 mes Drejtorit të ZVAP Vlorë dhe një grupi prej shtatë mësuesish të shkollës speciale, është zhvilluar përsëri një takim në të cilin mësuesit kanë paraqitur ankesa të tjera mbi mënyrën e drejtimit të institucionit arsimor nga ana e drejtores E.L.

ZVAP Vlorë me Urdhrin nr. 18, datë 03.02.2023 ka ngritur grupin e punës për shqyrtimin e ankesës të paraqitur në datë 01.02.2023 nga mësuesit e shkollës speciale. Grupi i punës me shkresën nr. 264/3, datë 07.02.2023 pas verifikimit të ankesave dhe konkluzioneve të arritura ka njoftuar shkollën speciale të marrë masa të menjëhershme për:

1. *Funksionimin normal të veprimtarisë së Komisionit të disiplinës në shkollë.*
2. *Regjistrimin e nxënësve në klasën e parë në përputhje me Rregulloren për funksionimin e IAP-ve.*
3. *Pasqyrimin e saktë të ditëve të punës në listëprezencën e IAP-së dhe dhënien e lejeve në përputhje me rastet e përcaktuara në Kodin e Punës.*
4. *Zhvillimin e mbledhjeve me këshillin e mësuesve për diskutimin dhe zgjidhjen mbi problematikat në IAP.*

ZVAP Vlorë me Urdhrin nr. 20, datë 10.02.2023 ka ngritur grupin e punës për shqyrtimin e konstatimit të titullarit të IAP-së të E.L me datë 08.02.2023, drejtuar Drejtorit të ZVAP Vlorë, lidhur me humbjen e dokumentacionit shkollor (regjistra).

Grupi i punës së ZVAP Vlorë me shkresën nr. 324/2, datë 22.02.2023 pas verifikimeve të kryera në shkollën speciale ka dërguar pranë shkollës konkluzionet e arritura dhe ka njoftuar drejtoreshën e shkollës speciale të vijojë menjëherë me kryerjen e veprimeve të nevojshme për:

- *Raportimin e humbjes së dokumentacionit shkollor në organet kompetente ligjzbatuese.*
- *Verifikimin e ligjshmërisë së regjistrimit të nxënësve në institucion.*
- *Verifikimin e mangësisë në amzat e institucionit brenda muajit mars 2023.*

Në vijim drejtorja e shkollës, ka ngritur grupin e punës për të rikontrolluar për herë të dytë regjistrat e shkollës speciale për 10 vitet e fundit dhe ka dalë në përfundimin se mungonin 4 regjistra⁶.

Në vijim E.L, në datë 02.03.2023 ka bërë kallëzim të veprës penale pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkollës së Parë Vlorë. Në mes të tjerash E.L ka deklaruar se: “.... Pasi është vendosur në dijeni drejtoresha e ZVAP Vlorë ka ardhur me një grup pune për të verifikuar dokumentacionin regjistra dhe amza dhe ka dal në konkluzione nga raporti i saj dhe më ka lënë detyrë të bëj raportimin e humbjes së dokumentacionit në organet kompetente ligjzbatuese si dhe problematikat e amzave dhe ligjshmërinë e regjistrimit të nxënësve në këtë institucion”. Në këtë

⁶ Referuar Relacionit të komisionit të shkollës nr. 58, datë 28.02.2023.

kallëzim, E.L nuk ka deklaruar/apo përmendur ndonjë shkelje nga ana e Drejtores së DRAP Fier, F.M apo Drejtores së ZVAP Vlorë, I.T.

Me shkresën nr. 108, datë 04.04.2023, Drejtorja e shkollës speciale ka informuar ZVAP Vlorë, lidhur me përmbushjen e detyrave të lëna pas inspektimeve nga ana e grupit të punës së ZVAP Vlorë dhe ka informuar për shkelje në regjistrimin e dy nxënësve në vitet shkollore 2015-2016 dhe 2016-2017.

Referuar deklaramenteve të palëve gjatë seancës dëgjimore, rezulton se në muajin prill 2023, shqetësimet lidhur me funksionimin e shkollës speciale Vlorë ishin drejtuar dhe në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për të cilat është zhvilluar dhe një takim në MAS.

Në vijim, Ministria e Arsimit dhe Sportit me Urdhrin nr. 186, datë 14.04.2023, ka ngritur grupin e punës për monitorimin e veprimtarisë së shkollës speciale Vlorë. Në përfundim të monitorimit grupi i punës ka dalë me Raportin nr. 2511/2, datë 08.05.2023, në të cilin ka dalë me përfundimet si më poshtë:

- *Drejtori i shkollës nuk ka hartuar planin afatmesëm sipas formatit të parashikuar, nuk ka vendim të veçantë, pjesë të planit për ngritjen e grupit të punës. Nuk është vëzhguar zbatimi i planit afatmesëm, për ti raportuar me shkrim çdo 6 muaj drejtorit, si dhe nuk ka raportuar një herë në vit në bordin e shkollës.*
- *Drejtori i shkollës ka ngritur grupin e punës për hartimin e planit vjetor të shkollës për vitin shkollor 2022-2023, të përbërë nga mësues, nxënës dhe prindër. Objektivat në planin vjetor të shkollës janë të përgjithshme dhe nuk plotësojnë kriterin për të qenë të matshëm që të bëjnë të mundur krahasimin e shkollës në vite.*
- *Drejtori i shkollës për monitorimin e veprimtarive të planifikuara për periudhën shtator 2022-prill 2023, nuk ka dokumentacionin dhe raporte monitorimi.*
- *Drejtori i shkollës nuk ka kryer vlerësimin e brendshëm për vitin shkollor 2021-2022, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar nga ana e saj, nëpërmjet analizës dhe reflektimit për arritjet dhe mundësitë për përmirësime.*
- *Drejtori i shkollës nuk ka realizuar procedurat e vlerësimit të brendshëm, për vitin shkollor 2022-2023 në nivel individual dhe në nivel organizmesh të IA-së.*
- *Drejtori i shkollës ka hartuar planet vjetore për realizimin e normës së vlerësimit të arritjeve me 4 orë në javë. Drejtuesja e shkollës nuk ka hartuar planin mujor të vlerësimit dhe grafikun e shpërndarjes së normës zyrtare për vlerësimin e procesit mësimor për secilin muaj të periudhës shtator 2022-prill 2023. Ajo nuk ka realizuar planin vjetor dhe mujor të normës së vlerësimit të arritjeve, vlerësimit të procesit mësimor dhe vlerësimit të dokumentacionit shkollor.*
- *Drejtori i shkollës nuk ka realizuar normën zyrtare për vlerësimin e arritjeve, normën e vlerësimit të cilësisë së procesit mësimor dhe normën e vlerësimit të dokumentacionit shkollor.*
-

- Drejtoria e shkollës nuk ka zhvilluar asnjë nga veprimtaritë e planifikuara në planin e zhvillimit profesional të punonjësve mësimorë, si dhe nuk dispononte asnjë material shoqërues.
- Formimi i klasave është bërë në kundërshtim me pikën 2, të seksionit A, të Kreut II, të Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018.
- Drejtoria e shkollës nuk ka plotësuar dosjet e punonjësve mësimorë me dokumentacionin e kërkuar në Udhëzimin e MAS nr. 12, datë 10.06.2021.
-
- Arsimimi i nxënësve në kushtet e shtëpisë, nuk është bërë në përputhje me germën b, të pikës 1, të nenit 81, të kreut XIV, të urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020, në të cilin përcaktohet se ZVAP-ja siguron arsimimin në shtëpi të nxënësve me AK, të cilët nuk mund të ndjekim shkollë të zakonshme ose të specializuar në arsimin bazë.
- Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, për vitin shkollor 2022-2023 ka shqyrtuar 6 ankesa nga 22 të paraqitura pranë këtij komisioni, ndërkohë që 16 ankesa të tjera nuk janë shqyrtuar me pretendimin e kryetarit të KES se kanë vështirësi në zëvendësimin e anëtarëve të komisionit, për shkak të mungesës së komunikimit ndërmjet drejtueses së institucionit dhe Komisionit të Etikës dhe Sjelljes.
-
- Stafit pedagogjik ka një qëndrim jo pozitiv ndaj menaxhimit dhe drejtimit të shkollës nga drejtori i saj, kjo referuar edhe përgjigjeve të pyetësorëve realizuar me mësues të shkollës.

Grupi i punës i MAS në raport ka dhënë dhe rekomandimet përkatëse drejtuar shkollës speciale, ZVAP Vlorë, DRAP Fier dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP).

Grupi i punës të MAS në përfundim të raportit nr. 2511/2, datë 08.05.2023, ka propozuar: “Mbështetur në pikat 2/a, ç dhe 3/a të nenit 54, të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 106, të kreut XVIII, të Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH”, dhe në paragrafin 15.3 të Kontratës Kolektive të Punës, DRAP Fier të fillojë procedurën disiplinore ndaj E.L, drejtor i shkollës speciale Vlorë, për mangësi të theksuara në realizimin e detyrës, për organizimin dhe menaxhimin joefektiv të institucionit”.

Ankuesja E.L është vënë në dijeni të raportit nr. 2511/3, datë 09.05.2023, të MAS, por nuk e ka kundërshtuar atë.

Në datë 31.05.2023, DRAP Fier ka kryer monitorim në shkollën speciale Vlorë, lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin nr. 2511/3, datë 09.05.2023 të dërguar nga MAS dhe në përfundim grupi i punës ka hartuar raportin nr. 520/2, datë 01.06.2023 dhe ka rekomanduar vijimin e zbatimit të planit të masave deri në plotësimin e rekomandimeve të lëna nga MAS.

Në vijim të raportit të grupit të punës së MAS, DRAP Fier me shkresën nr. 444/2, datë 24.05.2023 ka dërguar raportin e MAS pranë Komisionit të Disiplinës të DRAP Fier, i cili ka zhvilluar një seancë dëgjimore me drejtoresh E.L në datë 29.05.2023. Gjatë këtij takimi E.L ka dorëzuar shkresën nr. 148, datë 29.05.2023, lidhur me vlerësimin e saj mbi konkluzionet e paraqitura në raportin e grupit të kontrollit të MAS, në të cilin në mes të tjerash ka informuar Komisionin e Disiplinës të DRAP Fier, mbi hapat e ndërmarrë për përmbushjen e rekomandimeve dhe në mes të tjerash ka deklaruar se: *“Ky raport është një vlerë e shtuar për institucionin tonë pasi pasqyron realitetin në të cilin ndodhej institucioni që drejtoj dhe do të na ndihmojë të përmirësojmë punën në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimit arsimor. Në tërësinë e tij, ky raport prek dhe evidenton probleme të një harku kohor, ku edhe pse, prezenca ime ishte e munguar, do të doja që të shprehja dakordësinë për të gjitha vërejtjet e gjetura nga grupi i punës, duke përfaqësuar kështu edhe pjesën e stafit”*.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioni i Disiplinës së DRAP Fier me Vendimin nr. 577/1 prot, datë 01.06.2023, ka konstatuar se: *“Komisioni i disiplinës konstaton se problematikat dhe shkeljet e vërejtura nga grupi i monitorimit i MAS, në lidhje me kryerjen e detyrave dhe funksioneve zyrtare të drejtores së shkollës E.L, të pakontestuar nga ana e saj, përbëjnë parregullsi dhe dobësi të theksuara në menaxhimin e institucionit arsimor parauniversitar. Komisioni i disiplinës gjykon se masat disiplinore të rezervuara për komisionin e disiplinës janë të pamjaftueshme për këtë rast”* dhe për sa më sipër vendosi: *“T’i rekomandojë drejtorit të DRAP Fier të vijojë me procedimin disiplinor të drejtores së shkollës speciale Vlorë, E.L, mbështetur në pikën 1/b të shkronjës “B” të kreut II të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar, në pikën 16.3, germa “f” të nenit 16 të Kontratës Kolektive të punës, të nënshkruar midis Ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe sindikatave të sektorit të arsimit”*.

Në datë 12.06.2023, mes Drejtores së DRAP Fier dhe E.L është zhvilluar takimi dhe është mbajtur procesverbali, për të diskutuar mbi zgjidhjen e kontratës së punës mes palëve. Referuar procesverbalit të takimit datë 12.06.2023 rezulton se palët kanë diskutuar lidhur me gjetjet e raportit të MAS, në drejtim të drejtores së shkollës.

Me Vendimin nr. 40, datë 16.06.2023, *“Për zgjidhjen për shkaqe të justifikuar të Kontratës së Punës me E.L, në pozicionin drejtor e shkollës speciale Vlorë”*, DRAP Fier ka vendosur për zgjidhjen e kontratës së punës me E.L për shkelje të rënda të vazhdueshme të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni i punës sipas kontratës, të cilat vijnë të kenë pasoja për mirëqenien dhe sigurinë e nxënësve në institucionin arsimor parauniversitar që drejton, si edhe për funksionimin në tërësi të atij institucioni.

Në nenin 54, të ligjit nr. 69/2012 *“Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, parashikohen detyrat e drejtorit të institucionit arsimor, si vijon: *“1. Drejtori drejton veprimtarinë e institucionit arsimor. 2. Drejtori i institucionit arsimor, publik*

ose privat, është përgjegjës për: a) zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij; b) përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor; c) zbatimin dhe zhvillimin e kurrikulës; ç) menaxhimin e personelit dhe krijimin e kushteve për zhvillimin profesional të punonjësve të institucionit. 3. Drejtori i institucionit arsimor publik kryen edhe këto detyra: a) menaxhon institucionin, përfshirë edhe menaxhimin financiar; b); c).....”.

Në nenin 55, pika 3 të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar, parashikohet se: “3. Titullari i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, shkarkon drejtorin e institucionit arsimor publik për shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe akteve të tij nënligjore, shkelje të etikës e të sjelljes në institucion, si dhe për mosrealizime të institucionit”.

DRAP Fier është krijuar me datë 20.05.2019, bazuar në VKM-në nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”. Bazuar në pikën 11 të Kreut III të kësaj VKM, përcaktohet që: “Drejtorët e Drejtorive Rajonale emërojnë drejtorët e institucioneve arsimore publike (IAP), sipas udhëzimit përkatës të Ministrisë”. Në këtë kontekst, është Drejtori i DRAP-it që ka kompetencën për të emëruar dhe liruar nga detyra drejtorët e IAP-ve.

Bazuar në pikën 9 të Kreut III të, VKM nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, përcaktohet se: “Drejtoritë Rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar janë përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel rajonal dhe kryejnë këto detyra: a) Menaxhojnë, mbikëqyrin, vlerësojnë dhe kontrollojnë institucionet arsimore parauniversitare për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi....b) c)”.

Më nenin 42 të Rregullores për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, të miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 të MAS, parashikohen detyrat e drejtorit të institucionit arsimor, duke përcaktuar se: “1. Drejtori i IA-së është titullari i institucionit, që ka të drejtën e firmës dhe vulës së institucionit. 2. 3. Drejtori ka përgjegjësinë për zbatimin në IA të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi. 4. Drejtori ka përgjegjësi administrative dhe penale, në rastet e parashikuara nga ligji, për plotësimin, brenda afateve kohore, të amzës, indeksit të amzës, regjistrin të veçantë dhe të çdo dokumenti shkollor. 5. Drejtori ka përgjegjësinë për krijimin në institucion të klimës së bashkëpunimit dhe të respektit ndërmjet punonjësve arsimorë në institucion. 6.”.

Në nenin 106 të Rregullores sipërcituar parashikohen masat disiplinore për drejtorët e institucionin arsimor, si më poshtë: “1. Titullari i DRAP ngre komisionin e disiplinës, që shqyrton masën disiplinore për drejtorin e IA-së. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët janë përgjegjësit e sektorëve dhe specialistë të caktuar nga titullari. 2. Komisioni i disiplinës në DRAP vendos masën disiplinore për drejtorin e institucionit, kur konstaton: a) shkelje të

dispozitave të Kodit të Punës, ose LAPU-së, të akteve të tjera nënligjore dhe të Rregullores; b) shkelje të etikës e të sjelljes në institucion; c) moskryerje të detyrave, sipas përshkrimit të punës; ç) përsëritje të rezultateve të ulëta të shkollës në provimet kombëtare. 3. Masat që komisioni i disiplinës vendos për drejtorin, janë: a) qortim; b) vërejtje; c) paralajmërim për largim nga puna. 4. 5. Komisioni i disiplinës shqyrton marrjen e masave disiplinore ndaj drejtorit të IA-së, me kërkesën me shkrim të DRAP ose të ekipit të monitorimit e vlerësimit, ose të mësuesve, nxënësve të institucionit, të personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve dhe çdo personi që ka hyrë me leje në institucion. 6. Në rastet kur drejtori ka ushtruar dhunë ndaj nxënësve ose punonjësve të institucionit, dhe këto veprime janë të provuara, jepet masë disiplinore “Largim nga detyra”, përveç veprimeve të tjera që mund të ndiqen nga strukturat kompetente sipas legjislacionit në fuqi”.

Në nenin 16.3 Kontratës Kolektive të punës nr. 6145, datë 05.06.2018, të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe sindikatave të sektorit të arsimit, parashikohet se: *“Në rast të thyerjes së disiplinës në punë, dëmtimit të rëndë ose të përsëritur të pasurisë së institucionit, punëmarrësve u jepen këto masa disiplinore: a) Qortim. b) Vërejtje. c) Paralajmërim për largim nga puna. d) Zbritje në detyrë ose zbritje në një cikël më të ulët arsimit për 6 muaj. e) Dëshmipërblim i dëmit, në masën që vendosin palët nënshkruese të kësaj Kontrate ose Gjykata. f) Largim nga puna”.*

Në Kreun II, B, pika 1, 5 dhe 6, të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 *“Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar, parashikohen rastet e shkarkimit dhe pezullimit të drejtorit të IAP, në të cilin citohet se: “1. b. Pas rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për inspektimin, sigurimin e cilësisë, vlerësimin, menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të arsimit parauniversitar, për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për parregullsi ose dobësi të theksuara në menaxhimin e IAP.5. Drejtori i DRAP fillon procedurën për shkarkim të drejtorit të IAP duke respektuar Kodin e Punës dhe Kodin e Procedurave Administrative. 6. Drejtori i IAP ka të drejtë të dëgjohet nga drejtori i DRAP, para se të merret vendimi i shkarkimit të tij. Seanca dëgjimore e drejtorit të DRAP me drejtorin e IPAP mbahet shënim nga sekretari i drejtorit të DRAP dhe arkivohet”.*

Referuar dokumentacionit të cituar më sipër rezulton se, DRAP Fier dhe ZVAP Vlorë që në muajin dhjetor 2022 kanë qenë në dijeni të problematikave të funksionimit të shkollës speciale Vlorë. Rezulton se DRAP Fier dhe ZVAP Vlorë janë vënë në dijeni nga mësuesit e shkollës lidhur me problematikën në menaxhimin e shkollës speciale. Këto problematika të funksionimit dhe menaxhimit të shkollës speciale, ZVAP Vlorë i ka konstatuar nëpërmjet dy vlerësimeve që ka zhvilluar në shkollën speciale në të cilat, me shkresën nr. 3002/1, datë 28.12.2022 ka sugjeruar që DRAP Fier të zhvillojë inspektim në shkollën speciale dhe me shkresën nr. 264/3, datë 07.02.2023, ka njoftuar shkollën të marrë masa të menjëhershme për zgjidhjen e problematikave të konstatuara. Pra, që në muajt dhjetor 2022-janar 2023, ZVAP Vlorë dhe

DRAP Fier kanë konstatuar mangësi në funksionimin e shkollës speciale. Këto parregullsi më pas janë thelluar kur shkolla speciale dhe grupi i punës i ZVAP Vlorë kanë konstatuar humbjen e dokumentacionit shkollor, mangësi në ligjshmërinë e regjistrimit të nxënësve dhe mangësi në amzat e shkollës.

Lidhur me humbjen e dokumentacionit shkollor, rezulton se në datë 08.02.2023 drejtorja e shkollës ka konstatuar mungesën e regjistrave dhe ka njoftuar drejtoreshën e ZVAP Vlorë, e cila në datë 10.02.2023 ka ngritur grupin e punës për shqyrtimin e konstatimit të mungesës së dokumentacionit shkollor. Pas verifikimit të humbjes së dokumentacionit shkollor, grupi i punës i drejtuar nga drejtori i ZVAP Vlorë ka konkluduar se drejtorja e shkollës speciale, të raportojë në organet kompetente ligjzbatuese raportimin e humbjes së dokumentacionit shkollor, gjë të cilën drejtorja e shkollës speciale e ka bërë në datë 02.03.2023.

Lidhur me humbjen e dokumentacionit shkollor, rezulton se drejtorja e shkollës speciale me procesverbalin nr. 01, datë 20.10.2022 ka marrë në dorëzim dokumentacionin e institucionit arsimor, shkolla speciale Vlorë. Referuar shkresës nr. 324/2, datë 22.02.2023, deklarimit gjatë seancës dëgjimore dhe procesverbalit datë 12.06.2023 të mbajtur mes drejtoreshës së DRAP Fier dhe drejtoreshës së shkollës speciale, rezulton se ankuesja ka pranuar se ka marrë në dorëzim regjistrat me inventar dhe në këtë kuptim ka pasur dhe përgjegjësinë për ruajtjen dhe sigurinë e tyre.

Në Kreu XIX, neni 109, pika 1 të Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore përcaktohet se: *“Regjistrat e klasës sigurohen në sekretari (aty ku ka), ose në zyrën e drejtorit/nëndrejtorit të shkollës”*, ndërsa në nenin 113, pika 10 përcaktohet se: *“Drejtori njofton menjëherë policinë dhe bashkinë për vjedhje ose tentativë vjedhjeje në pronën e institucionit”*.

Bazuar në sa më sipër, rezulton se ruajtja e regjistrave të klasës është përgjegjësi institucionale e drejtuesit të shkollës, gjithashtu rezulton së E.L ka kallëzuar në prokurori humbjen e regjistrave, vetëm pasi i është kërkuar me shkrim nga ZVAP Vlorë me shkresën nr. 324/2, datë 22.02.2023.

Lidhur me përgjegjësinë penale të personave përgjegjës për humbjen/vjedhjen e dokumentacionit shkollor në shkollën speciale, regjistrimet e paligjshme të nxënësve në vite dhe dëmin financiar të shkaktuar, Komisioneri vlerëson se do jetë Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, e cila do nxjerrë përgjegjësinë penale të personave përgjegjës në funksionet e tyre si drejtues ose ish drejtues të shkollës speciale apo të personave përgjegjës në institucionet drejtuese të arsimit, pasi përgjegjësitë administrative të drejtuesve të shkollës speciale janë evidentuar në raportet e vlerësimit të shkollës të viteve 2020 dhe 2021.

Lidhur me marrjen e masës disiplinore të largimit nga puna të E.L, Komisioneri vlerëson se nga ana e DRAP Fier është respektuar procedura ligjore, lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës dhe dhënies së mundësisë ankueses për tu dëgjuar dhe për tu mbrojtur në lidhje me arsyet e lirimimit të saj nga pozicioni i drejtoreshës së shkollës speciale.

Komisioneri vlerëson se ndaj E.L si drejtores e shkollës speciale, në vijimësi janë konstatuar shkelje në menaxhimin dhe funksionimin e shkollës, referuar shkresave nr. 3002/1, datë 28.12.2022 dhe nr. 264/3, datë 07.02.2023 të ZVAP Vlorë dhe pavarësisht se një pjesë e përfundimeve të Raportit nr. 2511/2, datë 08.05.2023, të MAS janë shkelje të trashëguara nga drejtuesit e mëparshëm të shkollës speciale, përsëri shumë shkelje⁷ të konstatuara nga grupi i punës së MAS, janë përgjegjësi e menaxhimit të shkollës gjatë periudhës që E.L ka qenë drejtuese e shkollës, duke shtuar këtu dhe humbjen e regjistrave të shkollës.

Referuar Raportit të vlerësimit të shkollës speciale nr. 450/4, datë 31.08.2020 të DRAP Fier, Raportit të vlerësimit të shkollës speciale nr. 855/7, datë 29.06.2021 të DPAP dhe Raportit të vlerësimit të veprimtarisë së shkollës speciale nr. 475/4/1, datë 05.04.2022 të DRAP Fier, rezulton se ka pasur problematika në lidhje me menaxhinin e shkollës speciale, sidomos në regjistrimin e nxënësve dhe DRAP Fier dhe DPAP kanë mbajtur të njëjtin qëndrim si në rastin e E.L duke rekomanduar marrjen e masave administrative ndaj drejtueses së shkollës.

Referuar këtyre raporteve rezulton se në raportin nr. 450/4, datë 31.08.2020, DRAP Fier ka kërkuar të merret masë administrative për drejtuesen e shkollës speciale E.K, e cila ka dhënë dorëheqjen, miratuar me Vendimin nr. 12, datë 29.01.2021 të drejtores së DRAP Fier, B.Dh. Me Vendimin nr. 13, datë 29.01.2021, DRAP Fier ka komanduar në pozicionin e drejtores së shkollës speciale mësuesen A.K.

DPAP në raportin e vlerësimit të shkollës speciale nr. 855/7, datë 29.06.2021, ka konstatuar si shkelje, miratimin e dorëheqjes së drejtorit të shkollës speciale duke e sistemuar si mësuese brenda shkollës, pasi nuk ka pasur vënd vakant dhe ka rekomanduar marrjen e masave për fillimin e procedurës disiplinore ndaj personave përgjegjës në DRAP Fier.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara, Komisioneri vlerëson se, ankuesja në cilësinë e drejtores së shkollës speciale, nuk ka arritur të argumentojë dhe justifikojë mbajtjen sipas dispozitave ligjore të dokumentacionit shkollor dhe menaxhimit të institucionit, as para grupeve të vlerësimit të ZVAP Vlorë dhe MAS, as para Komisionit të Disiplinës dhe as para drejtorit të DRAP Fier. Deklarimi i E.L, se të gjitha shkeljet e konstatuara i përkisnin periudhës kur ajo nuk ishte drejtuese dhe se largimi i saj nga detyra është bërë për shkak të denoncimit të saj në Prokurori, është i pambështetur në fakte dhe prova, por ngelet në kuadër të deklarimeve të saj.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar rezulton se DRAP Fier ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe për drejtuesit e shkollave “Urani Rumbo” ZVAP Gjirokastrë, në vitin 2020, “Ibrahim Kushta” Vlorë, “Muço Delo” Vlorë dhe “Adem Vrapit” Roskovec, në vitin 2021, ku në bazë të gjetjeve të raporteve të vlerësimit të DPAP dhe DRAP Fier, kanë konstatuar kryerjen e veprimeve në shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore dhe shkelje në menaxhimin e institucionit arsimor dhe kanë marrë masën e zgjidhjes së kontratës së punës me drejtuesit e këtyre institucioneve arsimore.

⁷ Referuar faqes 27-28 të vendimit.

Sa më sipër rezulton se, inspektimi dhe vlerësimi i zbatimit të legjislacionit të arsimit nga ana e institucioneve arsimore, në varësi të DRAP Fier, është një praktikë që ndiqet në vijimësi dhe nuk është një praktikë që është zbatuar vetëm për shkollën speciale Vlorë, pasi nga ana e DRAP Fier, është ndjekur e njëjta procedurë dhe është mbajtur qëndrim i njëjtë, si në trajtimin e shkeljes së konstatuar të ankueses dhe të drejtuesve të shkollave të sipërcituara.

A.2. Lidhur me kërkesën e ankueses për tu emëruar si mësuese në një institucion të arsimit parauniversitar në Vlorë.

Në Kreut 12, pika 4, të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021 *“Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit dhe të mësuesit në dispozicion nga një vend pune, si dhe administrimi i portalit “Mësues për Shqipërinë”*”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Drejtuesit e DRAP-ve nuk mund të pranojnë dorëheqjet e drejtorëve dhe nëndrejtorëve të institucioneve arsimore parauniversitare, pa i sistemuar më parë në vende pune të lira dhe me ngarkesë të plotë, brenda të njëjtës ZVAP-je, me përjashtim të rasteve kur drejtorët apo nëndrejtorët largohen nga sistemi arsimor sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk kanë 5 (pesë) vite përvojë pune si drejtor/nëndrejtor apo mësues, apo nuk plotësojnë kriteret ligjore për të qenë mësues. Rastet e dorëheqjeve të drejtorëve dhe nëndrejtorëve të IA-ve me kërkesën për sistemim si mësues. i paraqiten menjëherë komisionit të lëvizjeve paralele në ZVAP, gjatë apo ndërmjet viteve shkollore. Komisioni i paraqet kërkesat drejtorit të institucionit arsimor ku lirohet vendi më i parë i punës. Drejtorët dhe nëndrejtorët që kanë paraqitur kërkesën për dorëheqje, nuk mund të refuzojnë më shumë se 3 (tri) vende pune si mësues të propozuara nga komisioni dhe emërimi u bëhet pa afat nga drejtori i IAP-së përkatëse”*.

Me Vendimin nr. 40, datë 16.06.2023, *“Për zgjidhjen për shkaqe të justifikuar të Kontratës së Punës me E.L, në pozicionin drejtorë e shkollës speciale Vlorë”*, DRAP Fier ka vendosur për zgjidhjen e kontratës së punës me E.L.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga palët rezulton E.L me shkresën/kërkesë datë 05.07.2023, të dërguar nëpërmjet shërbimit postar, drejtuar DRAP Fier ka kërkuar emërimin si mësuese në një institucion të arsimit parauniversitar në Vlorë. DRAP Fier ka marrë dijeni për shkresën/kërkesë të E.L në datë 05.07.2023, fakt ky që rezulton i provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar nr. RR444694465AA, por nuk i ka kthyer përgjigje ankueses.

Referuar Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021, të sipërcituar, Komisioneri vlerëson se në këtë udhëzim nuk ka të përcaktuar një dispozitë në të cilin të parashikohet rasti i largimit të një punonjësi nga pozicioni si drejtor dhe të emërimit si mësues, kur me drejtuesin e një institucioni arsimor zgjidhet kontrata e punës për shkelje të rënda të vazhdueshme të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni i punës dhe në këtë kuptim, nga ana e DRAP Fier nuk mund të bëhet emërimi i E.L në pozicionin si mësuese, pasi E.L nuk kishte dhënë dorëheqjen. Në Udhëzimin nr. 12/2021, të sipërcituar ka të parashikuar rastin e sistemimit me ngarkesë të plotë të drejtuesit të një institucioni arsimor, në rastin kur jep dorëheqjen.

Në përfundim, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Nga ana e DRAP Fier, janë ndjekur të gjithë procedurat dhe hapat, në mbështetje të akteve ligjore/nënligjore, për marrjen e masës disiplinore për ankuesen dhe E.L ka pasur informacionin e duhur dhe mundësinë për tu ankuar për raportin e vlerësimit të MAS.
- DRAP Fier, ka mbajtur të njëjtin qëndrim, për konstatimin e shkeljeve të akteve ligjore dhe nënligjore të arsimit parauniversitar dhe gjatë procesit të zgjidhjes së kontratës së punës me drejtues të tjerë të institucioneve arsimore.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”.

Në nenin 12/1/c) të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se DRAP Fier, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje të paligjshme nga ana e DRAP Fier, për shkakun e pretenduar nga ankuesja dhe për rrjedhojë nuk provohet se DRAP Fier ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuseses E.L, në të drejtën për punësim, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier, për shkakun e pretenduar prej saj.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA